

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7775 E diel 27 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga LORENC VANGJELI



Shqiptarët si pushtues në Shqipëri dhe puthja sovjetike

Plot 60 vjet më parë, në kohën kur burrat komunistë të politikës lindore putheshin në buzë me njëri-tjetrin, Enver Hoxha i dha shumë puthje sovjetike ...
Vijon në faqen 21

Opinion i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Marshi mbrapsht i timonierit

Nikolo Makiaveli në "Princi"-n (kryevepra mes shkrimeve të diplomatit, politikanit, historianit, filozofit dhe humanistit të shquar të Rilindjes Italiane) ...
Vijon në faqen 22



INTERVISTA

"Pse vendosa të rikthehem në PD"

Oketa: Kandidat për Bashkinë e Durrësit? Unë jam në politikë për më shumë se kaq

Ish-zv/kryeministri: Të gatshëm të hyjmë në zgjedhje të lira. Kontribuoj me aq sa mundem

Nga VALENTINA MADANI

Gazmend Oketa iku nga Partia Demokratike me kokën e kthyer pas... Iku si demokrat. Edhe larg saj mbeti i tillë. Në rikthim e mirëpritën të gjithë në shtëpinë e përbashkët të PD-së. U rikthye në orë jo të mira për PD-në pasi ...
Në faqen 4

KRIMI NE BASTAR TE TIRANES, 34-VJEÇARI U GJET PA NDJENJA NE RRUGE

VELLAI VRET ME HEKUR TE DASHURIN E MOTRES

Policia arreston të dyshuarin, 31-vjeçarin Esat Cuni dhe çiftin e bashkëshortëve për moskallzim krimi. 20-vjeçarja u kap në kasolle me babain e 3 fëmijëve



(Në foto) Fshati Bastar i Mesëm

Në faqen 7

ANALIZA E DITES

Historia ka nevojë për modele... ne duhet ta njohim atë

PËRPARIM KABO

Në faqen 10-11

PD PROTESTON

HEC-i në kanionin e Holtës, qeveria: Do të pezullohet përkohësisht

Në faqen 2

KRYEMINISTRI

Rama çel ekspozitën në Berlin, PD: Të japë dorëheqjen, ka papajtueshmëri

Në faqen 3

APELI NGA DURRESI

Bjellorusi kërkon ndihmë nga qelia: Më lironi ose do të vras veten

Në faqen 6

PERPLASJA



Letër Arta Markut: Prokurori ka qenë sigurims. Reagimi: Kurrë, është shpifje

Në faqen 5

Homazh për profesor Idriz Ajetin në përvjetorin e 102-të të lindjes

Kosovari që unifikoji gjuhën e shqiptarëve

Në brendësi: Gjeniu i violinçelit, Rostropoviç. Prozë nga Faruk Myrtaj

Nga BARDHYL DEMIRAJ

Profesor Idriz Ajeti mbush këtë vit plot 102 moshë kur kundroi për të parën herë agun e mëngjesit në Medvegjë. Nuk i kanë mbetur më bashkëmoshatarë në këtë jetë, në mos sosh komilitonë shkollë a universiteti, që të kenë fik-



suar në kujtesë datën kur i festonin ditëlindjet. Ndërkohë ish-studentë e ish-studentëve të tij, të gjithë të zbardhur nga mos harreken e rropaten ende sot të qëmtojnë dëshmi bindëse, nëse ditëlindja e tij përkon zyrtarisht me ditën e ...

Suplement

PROTESTA REAGIMET

HEC-i në kanionin e Holtës, ministrja Balluku: Punimet pezullohen për kohësisht

'Holta' bashkon në protestë PD, qytetarët dhe shoqërinë civile

Balla: Verifikim të thellë të gjitha kontratatave

PD organizoi dje një protestë në kanionin e Holtës, kundër ndërtimit të HEC që shkatërron ketë zonë të mbrojtur natyrore. Deputetëve demokrat i janë bashkuar edhe qytetarë të zonës, të cilët, gjithashtu, kundërshtojnë ndërtimin e HEC-it. I pranishëm në protestë kreu i Departamentit për Turizmin në PD, Jamarbër Maltezi tha se qeveria po mashtron qytetarët ndërsa thotë se HEC mbi Holtë është pezulluar, pasi sipas tij vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit është në fuqi me firmë dhe vullë nga Edi Rama. Maltezi komentoi, gjithashtu, edhe takimin e ministrave me banorët e zonës. "Dje kanë mashtruar qytetarët se ju kanë thënë që e kanë bllokuar, por, në fakt, vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit është në fuqi me firmë dhe vullë nga Edi Rama, Damiani dhe drejtoreja e planifikimit të territorit prandaj deklarata me gojë e kukullës së Edvinit është propagandë boshe. Ndërkaq në zonë është betonuar buzë kanionit" - u shpreh Maltezi. Ndërkohë në një status në rrjetet sociale deputeti i PD, Endri Hasa ndërsa ka publikuar foto të protestës si edhe video e mbi punimet për HEC-in, shkruan se shtrati pranë kanionin është shkatërruar. Ai apelon qytetarët e Gramshit dhe mbarë Shqipërisë që të mos lejojnë që shkatërrimi të vijojë.

QEVERIA

Qeveria ka zhvilluar një diskutim me banorët e Holtës në Gramsh për çështjen e HEC-it mbi kanionin e Holtës. Ndërsa banorët janë shprehur kundër ndërtimit që dëmton këtë pasuri natyrore dhe rrjedhimisht dhe gjendjen e zonës, ministrit Balluku e Klosi si dhe kreu i grupit parlamentar të PS-së Taulant Balla premtuan se nuk do të ketë asnjë projekt që prek interesin publik. "Procedura është pezulluar, sepse janë pezulluar të gjitha procedurat e HEC-eve nga dje. Ne jemi për mbrojtjen e interesit të publikut. Jemi sensitivë në këtë pikë. Jam e qartë se ju kemi bërë procedurat. Nuk tha askush që është e



Protesta e banorëve në Holtë

PD fton kuksianët e tropojanët në protestë, Paloka: Revoltë qytetare

Partia Demokratike ka nisur organizimin për protestën e 16 shkurtit që do të zhvillohet në Tiranë para Kryeministrisë. Por, përpara protestës së 16 shkurtit, opozita do të organizojë protesta në të gjitha qytetet nga data 2-12 shkurt, kundër qeverisë. Nën kryetari i PD-së, Edi Paloka ishte dje në Kukës ku zhvilloi takime me strukturat për organizimin. Paloka u shpreh se kuksianët do të protestojnë për varfërinë, tarifën në Rrugën e Kombit, koncesionet, por edhe probleme të tjera. "Protesta do të zh-



villohet për t'i dhënë një zë revoltës së qytetarëve, pakënaqësisë së qytetarëve ndaj qeverisë, e cila vetëm për interesat e qytetarëve nuk

paligjshme, por këtu kemi një reagim të banorëve, jo të vogël, sepse ka një impakt tek komuniteti. Ne jemi duke bërë disa punë të mira. Na duhet të dëgjojmë mendimin e njerëzve"-deklaroi ministri Balluku. Kurse ministri Bledi Klosi u shpreh: "Pezullimi i investimeve që realizuam dhe është shprehje e opinionit pub-

lik. Sot jemi në të satën dëgjësë për sa i përket pezullimit të disa iniciativave private për të cilat nuk kemi asgjë kundër por që duhet të shkojnë në të mirën e të gjithëve. Për ne grupi më i madh i interesit janë qytetarët. Sot jemi këtu për të dëgjuar opinionin publik dhe çfarë njerëzjtë mendojnë. Ky kanion është një nga poten-

DEKLARATA

"Vërtetë HEC-ët e vegjël kontribuojnë në ekonomi, por dhe mund të dëmtojnë ekonomikisht shumë më tepër sesa kontributi i tyre, nëse për një HEC-i të vogël i bie vlera një pasurie të madhe natyrore. Ndaj na duhet një ekuilibër perfekt mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së pasurive tona natyrore, të cilat janë pasuria më e madhe që ne shqiptarët kemi", tha ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë.

Kandidat për kryebashkiak në Shkodër? Bushati: S'kam ambicie lokale!

Ish-ministri i Jashtëm Ditmir Bushati përfundimisht mundësinë e kandidimit për postin e kryetarit të bashkisë në zgjedhjet e 30 qershorit. "Nuk kam asnjë ambicie lokale. Jemi në proces konsultimi për të përzgjedhur një kandidat", deklaroi z. Bushati. I deleguar i PS-së i qarkut të Shkodrës ka nisur takimet me strukturat vendore të kësaj partie. "Fokusi i takimit të sotëm është në lidhje me vendimarrjen e partisë PS të Asamblesë Kombëtare me detyrat që janë përcaktuar, për të fuqizuar praninë tonë në terren dhe të përgatisim strukturat për zgjedhjet e 30 qershorit". Pyetjes se a do të ketë kriter kandidatit, Bushati iu përgjigj: "Natyrisht që do të ketë kriter, ne bëjmë sondazhe me opinionin. Jemi në proces konsultimi për të përzgjedhur një kandidat ose kandidatë fituese, por edhe një grup këshilltarësh të bashkisë më të mirë".

Kryeministri Edi Rama me familjen në ekspozitën e hapur në Berlin



Bushati e Ndocaj bashkë në zgjedhjet e qershorit

Zef Bushati dhe Eduard Ndocaj firmosën dje bashkimin e partive të tyre në një sigël të vetme, atë të partisë Aleanca Demokratiane e Shqipërisë, demokristianët e djathtë dhe ato të majtë do të kenë në fokus të gjithë personat që ndihen të papërfaqësuar dhe të zhgënjyer nga PD, PS dhe LSI duke përfshirë të rinjtë, katolikët si edhe personat e besime të tjera. Zef Bushati tha: "Kemi një mesazh. Demokristianët, të bashkohemi që të jemi një zë më i fuqishëm. Kurse Eduard Ndocaj deklaroi: "I vetmi komunitet që nuk përfaqësohet janë demokristianët dhe komuniteti katolik. Sepse PS vjen nga Partia Punë dhe ata kanë qenë gjithmonë anti Zot. Pavarësisht kritikave për partitë kryesore, Aleanca Demokratiane e përfundimisht në një pol të tretë politik.

dhet ka kishit bërë shumë më parë, banorët na thanë se bllokohet hyrja në kanion. Nëse bllokohet hyrja, dëmtohet kanioni", deklaroi Balla. Sipas tij protesta e banorëve ia vlejti pasi solli reagimin e qeverisë teksa siguroi se çdo kontratë do kalohet në skaner dhe do të shihen të gjitha letrat për projektin.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ljaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415 -email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës

së Autotaktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



PD thirrje Kuvendit: Bëje të pavlefshëm mandatin, kryeministri reagon nga Gjermania

Ekspozita në Berlin, PD kërkon mandatin e Ramës: Shkeli ligjin

LSI: Rama po pastron paratë e drogës

Valentina Madani

Kryeministri Edi Rama ka hapur ekspozitën e tij personale në Berlin, Gjermani. Por Partia Demokratike kërkon mandatin e deputetit të kryeministrit Edi Rama duke e bazuar këtë në hapjen e ekspozitës së tij në Berlin, Gjermani, sipas saj në shkelle të ligjit. Deputetja Albana Vokshi i kërkoi dje Kuvendit të Shqipërisë të konstatojë papajtueshmërinë me funksionin e kryeministrit dhe të deklarojë mbarimin e mandatit të Edi Ramës në bazë të nenit 71 të Kushtetutës. Sipas PD-së Kryeministri hap ekspozita dhe shet vepra arti kur njëherazi ushtron detyrën si i pari i qeverisë. Demokratët thonë se hapja e ekspozitave dhe shitja e veprave të artit gjatë ushtrimit të detyrës së kryeministrit e bën të pavlefshëm mandatin e Edi Ramës. Sipas deputetes Albana Vokshi nga shitja e krijimtarisë së tij kreu i qeverisë ka deklaruar në 3 vjet 79 milionë lekë, duke shkelur hapur Kushtetutën dhe ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. "Gjithçka është në kundërshtim me ligjin dhe detyrën e tij si kryeministër dhe si deputet. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, përcakton në nenin 27 të tij se, "Kryeministri nuk mund të ushtrojë veprimtari private që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar", theksoi deputetja e PD-së. Sipas Vokshit, "Kuvendit të Shqipërisë i takon të mos sillt si vegël në duart e Edi Ramës, por të ushtrojë të drejtën e vet: të konstatojë papajtueshmërinë me funksionin e kryeministrit/deputetit dhe të deklarojë mbarimin e mandatit të Edi Ramës në bazë të nenit 71 të Kushtetutës". Deputetja demokratike përmendi se shumica e shqiptarëve jeton shumë më keq, por kryeministri as nuk do t'ia dijë. Sipas saj Edi Rama e ka braktisur detyrën për të hapur një ekspozitë në Berlin.



Deputetja Albana Vokshi

ALBANA VOKSHI

"Kuvendi duhet ta konstatojë menjëherë papajtueshmërinë. Duke shitur krijimtarinë e tij artistike, Edi Rama deklaruar më 3 vjet 79 milionë lekë, duke shkelur hapur Kushtetutën dhe ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. Paligjshmëria, abuzimi me pushtetin dhe pasurimi i babëzitur janë 3 tiparet kryesore të Edi Ramës në krye të qeverisjes së vendit", - tha zj.Vokshi.



"Rama të bëjë gati valixhet, i erdhi ora që të ikë"

Policia arreston protestuesin, banorët e Unazës rrethojnë komisariat

Policia shoqëroi dje në komisariat një prej protestuesve të Unazës së Re. Banorët, të shoqëruar edhe nga deputetët e opozitës protestuan para Komisarariatit nr. 2. Forcat policore të Komisarariatit nr. 2 kanë marrë nga shtëpia e tij shtetasin Besnik Doçi, një protestues i përditshëm i Unazës së Re, shtëpia e të cilit është planifikuar të prishet pa dëmshpërblim. Doçi ka qenë duke lyer shtëpinë e tij, por forcat e komisarariatit policor po përgatiten t'i presin fletë-arrestin, nën arsyetimin absurd të "ndërtimit pa leje". Ata kërkan lirinë e protestuesit duke lëshuar thirrje kundër policisë. "Ose lironi Besnikun, ose lironi zyrat", "O besnik, o hero gjithë Unaza ty të do". Janë këto thirrjet që kanë hedhur banorët e Astirit. Bashkë me protestuesit ishin edhe deputetët e Partisë Demokratike, të cilët prej më shumë se 80 ditësh janë në krah të banorëve që protestojnë në mbrojtje të shtëpive të tyre. Më herët banorët e Unazës së re, dolën sërish në protestë, duke kërkuar anulimin e projektit korrupsionit të Rilindjes. Ndërkohë banorët i bënë thirrje dhe kryeministrit Edi Rama që të largohet pasi ka ardhur ora që ai dhe kriminelët të bëjnë gati valixhet. "Bëni gati valixhet erdhi ora që të ikni. Edi Rama o legen prit Unazën se po vjen", ishin thirrjet e banorëve. Në mbështetje të tyre shkuan edhe deputetët e opozitës.

"Zgjedhja e ekipit të ri, përgjegjësi e Bashës"

'Vendoret', Duma: PD të nxjerrë kandidatët dhe të hyjë në zgjedhje

Deputetja e PD-së Grinda Duma e ftuar dje në emisionin "Kjo Javë" në News 24 komentoji dje zgjedhjet më të fundit në parti, zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Kryesisë dhe Sekretariatit. "Unë mbështes çdo aksion politik të PD-së, as e paragjykoj për mirë as për keq zgjedhjen e ekipit të ri, formula duhet të jetë fituese. Duhet të vijmë me të vërtetë tek njerëzit", - tha Duma. Deputetja e PD-së përmendi se kryesia duhet të jetë patjetër një trupë e mirë për të fituar zgjedhjet. Ajo shtoi se është pikërisht kryetari Basha ai që duhet të mbajë përgjegjësi për arrijtjen e suksesit të kësaj trupe. "Kryetari ka përgjegjësi të plotë për arrijtjen e suksesit një trupë, janë njerëz me përvojë, tani duhen parë politik-



BISED

"Gjithçka që më shqetëson mua e kam diskutuar edhe më Bashën i ka thënë s'kemi më asnjë luks për të eksperimentuar. Mua me dhimbën demokratët, janë ata që kanë bërë opozitë në ditë të këqija, pa punë, me borxhe", - tha Duma.

isht. Votimi për zgjedhjet e tyre ishte transparent, gjatë numërimit nuk kam qenë prezentë, por procesi i numërimit është nën përgjegjësinë e kryetarit. Mekanizmat për të kuptuar kuajt fitues është gara transparente e thellë dhe e plotë", - tha zj.Duma. Deputetja demokratike foli edhe për kandidaturat e PD-së,

për zgjedhjet vendore të këtij viti. Ajo vuri në dukje se PD ka mjaft kandidatë, por problem i saj është të zgjedhë më të mirin ndër ta. "Padyshim që problemi i saj është të zgjedhë kush është më i miri ndër ata, dhe të marrë vendimmarrjen e saktë, sa më shpejt", - u shpreh zj.Duma.

denoncoi me fakte lidhjet e qeverisë shqiptare me krimin. "Ndonëse Shqipëria është e mbërthyer nga bora, është në palcën e Dimrit, mijëra studentë janë në një revoltë plotësisht legjitime që ka ardhur pikërisht nga roli negativ, shumë destruktiv dhe aspak zgjidhës i kryeministrit të Shqipërisë dhe megjithatë, pikërisht në valën e gjithë këtyre problemeve kryeministri i Shqipërisë ndodhet në Gjermani për ekspozitën e tij. Ti kryeministër që ndodhesh në

Gjermani sot në ekspozitën e pikturës, në ekspozitën e punëve të tua, në ekspozitën e gefeve të tua, por pikërisht në Gjermani të gjithë e kanë të qartë dhe nuk kanë nevojë të shikojnë ekspozitat dhe pikturat e tua, pasi pikturën më të qartë për çfarë bën ti me qeverisjen tënde, atë për të cilën ti je ngarkuar nga populli që të bësh, ata e kanë shumë të qartë në librin "Partneri kriminal", u shpreh z.Vasili. Por pas videoes me familjen që publikoi mbërmbjen e premtës, dje

kreu i qeverisë publikoi një tjetër foto nga ekspozita. Rama duket teksa vendos një nga pikturat e tij në ekspozitë, e cila ka tërhequr edhe vëmendjen e disa medieve në Berlin. Ndërkohë që në Tiranë opozita akuzoi se hapja e ekspozitave dhe shitja e veprave të artit gjatë ushtrimit të detyrës së kryeministrit e bën të pavlefshëm mandatin e Edi Ramës. Sipas opozitës vendi ka hyrë në rrugë të tmerrshme, për shkak të lidhjeve të qeverisë me krimin.

AKSIONI I OPOZITËS

INTERVISTA

Valentina Madani

Gazmend Oketa iku nga Partia Demokratike me kokën e kthyer pas... Iku si demokrat. Edhe larg saj mbeti i tillë. Në rikthim e mirëpritën të gjithë në shtëpinë e përbashkët të PD-së. U rikthye në orë jo të mira për PD-në pasi aksioni i saj politik ka shënjuar rrezimin e qeverisë "Rama". Pikërisht kësaj beteje ka vendosur t'i bashkohet edhe Gazmend Oketa, ish-ministër i Mbrojtjes, aktualisht pjesë e forumit të Këshillit Kombëtar të PD-së. Ndaj z. Oketa thotë për "Gazeta Shqiptare" se është i gatshëm të kontribuojë duke lënë të hapur mundësinë e kandidimit në Durrës me 30 qershor për kreun e Bashkisë së këtij qyteti. "Unë jam në PD për më shumë se kaq. Unë jam në politikë për të kontribuar me aq sa mundem për ndërtimin e një sistemi politik vërtet demokratik", - shpreh z. Oketa.

Z. Oketa, cilat ishin shtyosat që ju rikthyen në Partinë Demokratike?

U riktheva në PD për shkak të zhvillimeve politike në vend. Lëvizja e studentëve dhe protesta me këtu besimin se mund të ndryshojë situatën, protesta e banorëve të Astirit si dhe ajo e Teatrit Kombëtar. Unë besoj se mjafton të përmendim rastin e fundit të Unazës së Re, që nga buxheti do të avullonin 30 milionë euro. Miqtë e mi më të mirë janë tek e djathta.

Tashmë në PD shohim në ngjitje figura të reja. Si e shikoni ekipin e ri të Lulzim Bashës të dalë nga zgjedhjet e brendshme në PD?

Së pari, e shikoj si ekip, i cili përfaqëson të gjithë anëtarësinë e PD-së dhe jo si një ekip personal të z. Bashës. Nëse anëtarët e këtij ekipi do ishin emëruar nga z. Bashës, atëherë ai mund të quhej ekipi i tij. Në fakt, anëtarët e Kryesisë si dhe sekretarët, ndodhen në ato pozicione pas një procesi votimi në Këshillin Kombëtar të PD. Në gjykimin tim, ai është një ekip, i cili përmbledh brenda tij individualitetet, eksperiencat dhe karakteret të ndryshme. Tek secili prej tyre, besoj se gjithkush mund të gjejë një përfaqësues të tij. Mendoj se në mënyrë krejt normale, anëtarët e Këshillit Kombëtar kanë bërë një shpërndarje vote, duke zgjedhur në Kryesi, si njerëz me eksperiencë politike apo organizative, ashtu dhe individë të rinj apo dhe të ashtuquajtur zëra ndryshe. Personalisht do t'i uroja gjithsecilit prej tyre sukses, dhe që ky sukses të jetë sa më i plotë, uroj që të gjithë ata të bashkëpunojnë plotësisht me njëri-tjetrin, ashtu siç një ekip të mirë i takon, si dhe respekt të vlerave të gjithsecilit. Kjo besoj se do ta bënte atë një ekip fitues.

Ju jeni nga ata demo-

"PD, e gatshme të hyjë në zgjedhje të lira dhe të rifitojë besimin e qytetarëve"

Kandidimi në Durrës, Oketa: Jam në PD për më shumë se kaq

"Në politikë për të kontribuar me aq sa mundem"

kratë që e njihni mirë bazën e partisë dhe strukturat e saj, por referuar lidhës së kryesisë së re të PD-së a besoni se anëtarët e saj realisht e njohin terrenin...?

Një pjesë e mirë e tyre gjykoj se e njohin mjaft mirë terrenin si dhe anëtarësinë e PD-së në shumicën e qyteteve. Pjesa tjetër, e cila mund të mos ketë këtë lloj "avantazhi", jam i sigurt se do mundet të krijojë dhe ajo njohjet apo eksperiencën e saj. Një ekip është interesant kur jo të gjithë ata që e përbëjnë kanë të njëjtin format. Përfytyroni një ekip futbollit i cili do t'i kishte të gjithë lojtarët mbrojtës apo mesfushorë. Është e sigurt që do dilte i humbur në çdo ndeshje.

Nisur nga lista e propozuar nga z. Bashës për anëtarë në Këshillin Kombëtar të PD-së, por edhe në kryesi, duket se ka një tentativë për të afruar sa më shumë kontribuues të PD-së në strukturat të larta të partisë. Sipas jush kush tjetër duhet t'i bashkohet PD-së?

Unë mendoj çështja nuk shtohet vetëm për ata që duhet t'i afrohen partitë PD-së. Sot gjykoj se bëhet fjalë për dikë më të madhe se PD. Sot është në diskutim e tashmja dhe e ardhmja e Shqipërisë. Fatkeqësisht Shqipëria ndodhet në një situatë kur pothuaj e gjithë shtresa e mesme e shoqërisë, të gjithë të arsimuarit, edhe pse ndoshta kanë një mundësi ekonomike relativisht të pranueshme, duan të largohen. Ata po zgjedhin të shkojnë drejt një të panjohure më të madhe, sepse kanë pësuar zhgënjimin e madh dhe e shohin me pasiguri të ardhmen. Në vend që të largohen, dhe që kjo situatë të ndryshojë, unë mendoj se nuk është e thënë që e gjithë shoqëria të anëtarësohet në një grupim politik. Ajo që duhet të bëjë shoqëria shqiptare sot është që duhet të reagojë, duhet të mos paragjykojë opozitën, por të mbështetë ato çështje ku opozita ka të drejtë dhe të ngrihet sa herë që gjykon se qeveria po keq qeveris apo po abuzon me pushtetin. Nuk ka nevojë të jesh anëtar partie, për të mbështetur çështjen e Teatrit Kombëtar, protestën e studentëve, protestën e unazës së re, të protestosh kundër koncesioneve apo vjedhjes së



Gazmend Oketa, ish-ministër i Mbrojtjes

parasë publike, siç është rasti i projektit krejtësisht korruptiv të unazës së re.

Z. Bashës kërkoi mobilizimin e të gjithë demokratëve për të nisur një sezon protestash, të cilat do të kulmojnë me largimin e Edi Ramës. Sa të mundur e shikoni ju këtë?

Unë besoj se pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare është e pakënaqur me qeverinë aktuale, është e pakënaqur me mënyrën se si kryeministri i vendit, z. Rama po drejton vendin, është e indinjuar me faktin se ai po abuzon me pushtetin dhe se ai po përgëndon në duart e tij të gjitha pushtetet. Ai ka pushtet absolut politik brenda Rilindjes, ai ka pushtet absolut

rezerva nuk duhet të kthehen në një mundësi më shumë për qeverinë aktuale, për më shumë abuzim me pushtetin, me parandë publike, me drejtësinë apo me gjithçka që ajo kontrollon. Reagimi qytetar duhet të jetë i tillë që të përcjellë një mesazh të fortë e të qartë tek e gjithë politika. Mesazhi duhet të jetë fare i thjeshtë, "Ti nuk më shërben, unë të largoj nga pushteti". Opozita e sotme, dha llogari para qytetarëve shqiptarë 6 vite më parë. Sot është dita që qeveria aktuale të japë llogari për tepsinë apo timonin që e ka krejtësisht e vetme. Qeveria aktuale, apo më saktë z. Rama, është përgjegjësi i vetëm për keq-qeverisjen,

EKIPI

"Një ekip është interesant kur jo të gjithë ata që e përbëjnë kanë të njëjtin format. Përfytyroni një ekip futbollit, i cili do t'i kishte të gjithë lojtarët mbrojtës apo mesfushorë. Është e sigurt që do dilte i humbur në çdo ndeshje", - u shpreh anëtar i Këshillit Kombëtar të PD.

në qeverisje, ai po shtrin pushtetin e tij në drejtësi. Ai ka krijuar një super pushtet mbi ekonominë shqiptare, duke përqendruar gjithçka në pak duar, por çka është dhe më e keqja, pas kriminalizimit të politikës, nëpërmjet krijimit të kushteve për pastrim të parave të pista po kriminalizohet edhe ekonomia. Në një situatë të tillë unë e shikoj më shumë se të nevojshëm reagimin e shoqërisë shqiptare. Unë mirëkuptoj cilindo që ka rezervë

papunësinë, shëndetësinë që ju vetëm nuk është falas, por është shumë e shtrenjtë për xhepat e qytetarëve shqiptarë, për arsimin, i cili për shkak të një ligji krejtësisht klientelist ka futur të gjithë sistemin arsimor në kolaps, për drejtësinë pa drejtësi që vazhdojmë të kemi. Besoj se këto e shumë arsye të tjera, duhet t'i bëjnë shqiptarët të reagojnë, siç dhe opozita duhet të marrë përgjegjësinë për të përcjellë mesazhet e duhura dhe për të mirë orientuar pakënaqësinë popullore.

KANDIDIMI

"Unë jam në PD për më shumë se kaq. Unë jam në politikë për të kontribuar me aq sa mundem për ndërtimin e një sistemi politik vërtet demokratik. Nëse arrijmë të ndërtojmë një sistem të tillë, ju siguroj se gjithçka do të ishte më e lehtë për cilindo prej nesh, pavarësisht bindjeve apo krahit politik", - deklaroi z. Oketa.

Drejtuesit e PD-së janë shprehur se nuk synohet marrja e pushtetit përmes protestave, por garancia për zgjedhje të lira. A është e gatshme PD të fitojë zgjedhjet dhe nesër të qeverisë ndryshe shqiptarët?

Që PD nuk synon marrjen e pushtetit nëpërmjet protestave nuk është vetëm çështje deklarimesh, por edhe realiteti. Sa herë PD-ja ka ardhur në pushtet, ka ardhur me votë të lirë. Krijimi i kushteve për një sistem zgjedhës të lira, të ndershme pa përzjerjen e grupeve kriminale në to, nuk është thjesht një problem i PD-së. Ai është një problem, i cili në rast se nuk zgjidhet do vazhdojë të prodhojë qeveri e qeveritarë të pa-përgjegjshëm, abuzues me pushtetin, pushtetarë që do punojnë për interesat e atyre që vjedhin, blejnë apo shantazhojnë qytetarët për votat. Në këtë kontekst, zgjedhjet e lira shkojnë përtej interesit të një apo disa partive politike. Ato kanë të bëjnë direkt me interesin publik, me mundësinë që qytetarët të zgjedhin vetë përfaqësuesit e tyre. Pa më të vogël mëdyshje ju them se PD-së, është e gatshme në çdo moment të marrë pjesë në zgjedhje të lira dhe nëpërmjet përfaqësuesve të saj më të mirë të rifitojë besimin e qytetarëve dhe mbështetjen e tyre me votë të lirë.

Nëse do të ketë garë të ndershme në zgjedhjet lokale, a besoni se shqiptarët me votën e tyre do t'i besojnë opozitës?

Është e pafalshme për të gjithë klasën politike shqiptare që pas 28 viteve nga përmbyjsja e regjimit komu-

nist, diskutohet për zgjedhje të lira e të ndershme. Megjithatë duke uruar e shpresuar se këto zgjedhje do jenë të lira përgjigjja ime është kjo. Zgjedhjet lokale janë të vetmet zgjedhje ku qytetarët votojnë dhe zgjedhin vetë përfaqësuesin e tyre. E thënë më thjeshtë, janë të vetmet zgjedhje ku qytetarët nuk votojnë kryetarin e partisë politike, por votojnë emrat e kandidatëve për kryetar bashkie. Kjo i jep një mundësi të mirë qytetarëve të bëjnë zgjedhjen e tyre. Detyra e PD-së është të përfaqësohet me kandidatë dinjitozë, të cilët dinë të përfaqësojnë më së miri interesat e komunitetit ku bëjnë pjesë. Detyra e PD-së apo çdo force tjetër në këto farë mënyre përfundon aty. Nga ky moment, përgjegjësia duhet të jetë e qytetarëve, të cilët duhet të kuptojnë se kur votohet për kryetar bashkie, duhet të zgjidhet ai kandidat i cili i shërben më mirë atyre, pavarësisht se nga cila forcë politike vjen. Unë besoj se PD-ja do e përmbyshë më së miri detyrën e saj duke i ofruar qytetarëve mundat për të mira të mundshme, dhe këta kandidatë së bashku me ekipet e tyre do të ofrojnë zgjedhjet më të mira për problemet e përditshme që kanë qytetarët shqiptarë në bashkitë ku ata jetojnë.

Ndryshe nga opozita, mazhoranca ka nisur të flasë me emra kandidatësh që do të garojnë me 30 qershor...

Sa për Rilindjen, nisur dhe nga lëvizjet e fundit në qeveri, besoj se do jenë kandidatura që do përfaqësojnë vetëm z. Rama, pasi fatkeqësisht duket sikur Partia Socialiste tashmë pothuaj ka mbetur thjesht një simbol.

Në PD flitet se ju jeni ndër kandidatët më të mundshëm për të garuar për kreun e Bashkisë së Durrësit nisur nga mbështetja që ju keni në këtë qytet. Por nëse ju kërkohet një gjë e tillë nga z. Bashës, a do të pranoni të kandidoni në Durrës?

Unë jam në PD për më shumë se kaq. Unë jam në politikë për të kontribuar me aq sa mundem për ndërtimin e një sistemi politik vërtet demokratik. Nëse arrijmë të ndërtojmë një sistem të tillë, ju siguroj se gjithçka do të ishte më e lehtë për cilindo prej nesh pavarësisht bindjeve apo krahit politik. Nëse do ndërtojmë një sistem të tillë, Shqipëria do të ishte vërtetë foleja e duhur e shqiptarëve. Unë nuk e shoh politikën, thjesht çështje emri apo emrash. Ajo duhet të jetë e bazuar në një sistem vlerash, parimesh, idesh progresiste, e fokusuar tek interesi publik. Ajo duhet të krijojë një terren ku të rinjtë që afrohen aty, të sjellin energji, ide të reja, të përgatiten për të qenë drejtuesit e nesërëm dhe jo të jenë thjesht kopje të njërit apo tjetrit drejtues.

KESHILLI I PROKURORISE VERIFIKIMI

Ngatërresë apo e vërtetë? Opozita: S'duhet të jetë anëtar i KLP-së

Autoriteti i dosjeve, Arta Marku: Prokurori Sheshi ka qenë "sigurims"

Prokurori: S'kam qenë kurrë, është shpifje

Besar Likmeta

Në një bisedë të shkurtër telefonike mesditën e të shtunës, prokurori Bujar Sheshi i tha BIRN se do të reagoonte kur të merrte dokumentet zyrtare, por kundërshtoi akuzat në media dhe nga Partia Demokratike se ka qenë bashkëpunëtor i policisë sekrete.

"Është shpifje, nuk kam qenë kurrë anëtar i Sigurimit të Shtetit," tha ai.

Prokurori Bujar Sheshi ka një karrierë të gjatë si jurist dhe përfaqësues i institucionit të akuzës në Shqipëri. Në vitet 1994-1997, ai ka punuar si avokat. Për më shumë se një dekadë mes viteve 2003-2015 ai ka punuar si prokuror i çështjeve të Gjykatës e Lartë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ndërkohë që në janar 2015 është emëruar si prokuror pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Më 11 dhjetor 2018, Sheshi u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Si pjesë e vlerësimit të kandidatit të tij, Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme Arta Marku i ka kërkuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me datë 26 tetor 2018, verifikimin e figurës së tij.

Me datë 22 janar, Autoriteti i ka marrë një vendim për të informuar Prokurorin e Përgjithshëm, se nga kontrolli i cilësive etike, morale dhe profesionale të zotit Bujar Sheshi, ka rezultuar se ai rezulton në dokumentet e ish-Sigurimit si bashkëpunëtor në kohën kur ka qenë nxënës në gjimnazin "Petro Nini Luarasi" në Tiranë, por nuk disponohen dokumente për rolin e tij. Gjithashtu, i njëjti vendim nënvizon se Sheshi figuron në të njëjtat dokumente si anëtar me detyrë hetues, në Hetuesinë e Degës së Punëve të Brendshme Fier.

Ky vendim i Autoritetit është miratuar me shumicë votash. Në favor të vendimit kanë votuar kryetarja Gentiana Sula dhe anëtarët Altin Hoxha dhe Simon Miraka. Kundër vendimit është rreshtuar Dr. Marennglen Kasmi.

IDENTITETIN E BASHKËPUNËTORIT

Gjatë regjimit komunist, ish-diktatori Enver Hoxha



Prokurori Bujar Sheshi



Faksimile e vendimit të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

burgosi dhjetëra-mijëra vetë dhe mijëra të tjerë u pushkatuan ose vdiqën nëpër kampe pune me ndihmën e policisë sekrete, ish-Sigurimit të Shtetit. Në prill 2015, parlamenti miratoi ngritjen e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, e cili do të hapte për publikun dosjet e viktimave dhe bashkëpunëtorëve të ish-shërbimit famëkeq.

Dokumentet e Autoritetit i publikuar në media - autenticitetin e të cilit BIRN nuk mund ta verifikojnë në mënyrë të pavarur, shprehet se gjeneralitetet e bashkëpunëtorit të ish-sigurimit në kartelën Model 2, nr. 8023 janë "Bujar Rasim Shesha" i datëlindjes 1957, ndërkohë që gjeneralitetet e prokurorit janë Bujar Ramiz Sheshi, i datëlindjes 15.12.1957. Por nga veri-

DOKUMENTI

Dokumenti i Autoritetit i publikuar në media, shprehet se gjeneralitetet e bashkëpunëtorit të ish-sigurimit në kartelën Model 2, nr. 8023 janë "Bujar Rasim Shesha" i datëlindjes 1957, ndërkohë që gjeneralitetet e prokurorit janë Bujar Ramiz Sheshi, i datëlindjes 15.12.1957.

fikimet e kryera në Dretorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ka rezultuar se në Regjistrin Kombëtar të vitit 2010, nuk ka persona me gjeneralitetet "Bujar Ramis Sheshi" ose "Bujar Ramis Shesha" - çfarë e ka shtyrë Autoritetin në përfundimin se kartela nr.8023, i përket anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Sipas kësaj karte ai është

Deklarata



REAGIMI I PD

"Bujar Sheshi nuk duhet të ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por Arta Marku e kualifikoi në kundërshtim me ligjin që qeveria dhe ajo vetë ta shantazhojnë për ta mbajtur nën kontroll", - deklaroi Gent Strazimiri.

të rekrutuar në vitin 1974, gjatë periudhës që ishte nxënës në gjimnazin "Petro Nini Luarasi" në Tiranë, me pseudonimin Venusi dhe dosja është mbyllur pas 10 muajsh në tetor 2015-të. Sipas Autoritetit nuk ka dokumente që të hedhin dritë mbi aktivitetin e tij gjatë kësaj periudhë.

Prokurori Sheshi kaloi në tetor procesin e vetingut duke u rikonfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Të qenit bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit nuk është një nga kriteret diskualifikuese të procesit të vetingut, por është kusht për prokurorët që bëhen pjesë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku Sheshi u zgjodh si anëtar në dhjetor. Opozita sulmon Arta Markun

Në një konferencë për shtyp të dielën, deputeti i Partisë Demokratike Gent Strazimiri është shprehur se prokurori Bujar Sheshi, nuk duhet të ishte zgjedhur si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke e akuzuar Prokurorin e Përgjithshme të Përkohshme, Arta Marku se e ka kualifikuar kandidaturën e tij në kundërshtim me ligjin.

"Bujar Sheshi nuk duhet të ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por Arta Marku e kualifikoi në kundërshtim me ligjin që qeveria dhe ajo vetë ta shantazhojnë për ta mbajtur nën kontroll", deklaroi Strazimiri. "Ligji Për organet e

qeverisë së sistemit të drejtësisë', e ngarkon Arta Markun me përgjegjësi direkte, pasi në nenin 279, përcaktohet se Prokurori i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore për anëtarët e KLP-së," shtoi ai.

Strazimiri ngriti pikëpyetje pse Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, e kishte marrë vendimin mbi përshatshmërinë e prokurorit Sheshi tre muaj me vonë, duke aluduar se maxhoranca po e ndëshkonte tani këtë fundit për arsye politike. Sipas relacionit të prodhuar nga Prokuroria e Përgjithshme mbi Verifikimin e plotësimit të kushteve të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, organi i akuzës ka qenë në pritje të konfirmimit të Autoritetit kur ka vendosur se prokurori Bujar Sheshi i ka plotësuar kushtet ligjore për kandidimin në KLP.

"Për verifikimin e pikës "dh" "e", për kushtet, kandidati ka paraqitur deklaratat, dhe nga ana jonë është kërkuar konfirmimi dhe në Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit," shkruhet në relacionin e Prokurorisë.

Sipas dokumentit të publikuar në media, "konfirmimi" nga ana e Autoritetit është marrë vetëm me datë 22 janar. Zëdhënësi i Prokurorisë së Përgjithshme nuk ishte i arritshëm për koment mbi akuzat e Partisë Demokratike ditën e shtunës.

Trafikoi 2 tonë kanabis, mediat italiane:
Kapet në Shqipëri 23-vjeçari në kërkim

ITALI - Një shqiptar i kërkuar që prej dy vitesh nga drejtësia italiane ka përfunduar në pranga. Mediat e vendit fqinj bëjnë me dije se gjatë një operacioni të përbashkët me policinë shqiptare është arrestuar në Shqipëri, i dyshuar si trafikant droge, Armano Elezi. Ky i fundit, në gusht të 2016-ës i kishte shpëtuar policisë italiane, gjatë operacionit për arrestimin e trafikantëve që u kapën me 2 tonë marijuana. Pesë persona u kapën menjëherë nga policia e Ankonës dhe Pesaros, por njëri prej trafikantëve arriti të shpëtonte. "23 vjeçari u arrestua në Shqipëri dhe pritet ekstradimi drejt Italisë, për të nisur gjyqin", raportojnë mediat italiane.



Arrestohet finlandezi i shumëkërkuar, i dënua
me 3.11 vite burg nga Gjykata e Helsinkit

TIRANË - Policia e Tiranës në bashkëpunim me INTERPOL ka vënë në pranga një shtetas finlandez, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar. Mësohet se 34-vjeçari me inicialet M.S. u kap pasi, Gjykata e Apelit në Helsinki në prill të vitit 2018 e ka dënua me 3 vjet e 11

muaj burgim, për vepra penale të rënda në fushën e narkotikëve, armëmbajtje pa leje dhe shumë raste të përsëritura në disa qytete në Finlandë, në periudhën dhjetor 2016-prill 2017, ku ka shkaktuar panik dhe rrezik për qytetarët duke drejtuar automjetin nën efektin e lëndëve narkotike dhe pa leje drejtimi.

Shtetasit finlandez M.S., kryeson listën e personave të kërkuar në Finlandë, kjo sipas konfirmimit të Interpol Helsinkit, për shkak të panikut dhe rrezikut që ka shkaktuar për qytetarët. Arrestimi provizor i shtetasit M.S., u bë me qëllim ekstradimi drejt Finlandës.

Gruaja e 36-vjeçarit: Administrata tallet me burrin, i thonë do të çojmë në psikiatri

TIRANË

Një 36-vjeçar nga Bjellorusia, rezident në Malin e Zi dhe që aktualisht ndodhet në paraburgim në Durrës, dhe ka kërkuar ndihmë, duke thënë se nëse nuk e lirojnë do të vrasë veten. Bëhet fjalë për Maxim Barycaun, i cili ka telefonuar në redaksinë e BalkanWeb, ndërsa është shprehur se po mbahet padrejtësisht në burg kur kanë kaluar të gjitha afatet dhe është shkelur vendimi i Gjykatës. Ndërkaq shtetasi nga Bjellorusia ka rrëfyer se është arrestuar 6 muaj më parë për llogari të Malit të Zi, ku akuzohet për mashtrim. Por megjithëse kanë kaluar të gjitha afatet dhe të ekstradimit, ai nuk është liru ende. 36-vjeçari kërkon reagimin e institucioneve shqiptare, duke kërcënuar se në rast të kundërt do të vetëvritet. Në një intervistë dhënë për "BalkanWeb" ai ka treguar me detaje se si është ekstraduar nga Indonezia në Shqipëri, qëndrimin në qelitet dhe burgut si dhe përplasjen me institucionet shqiptare.

Bjellorusi kërkon ndihmë, nga paraburgimi në Durrës: Më lironi ose do të vras veten

Maxim Barycaun i ekstraduar nga Indonezia: Kanë mbaruar të gjitha afatet, duhej të isha liru



36-vjeçari nga Bjellorusia, Maxim Barycaun



Bjellorusi me bashkeshorten

Cfarë ka ndodhur me ju?
Jam një shtetas bjellorus. Quhem, Maxim Barycaun, 36 vjeç. Më ka mbaruar afati i ekstradimit. I kam të gjitha dokumentet, të cilat thonë se brenda kësaj date ose duhet të ekstradohem ose të lirohem.

Kam 6 muaj në burg. Më 27.12.2018 është mbyll vendimi nga Gjykata e Lartë dhe brenda 30 ditëve duhet ose të lirohesha ose të ekstradohesha.

Për çfarë jeni akuzuar dhe ndaluar?

Jam akuzuar për mashtrim. Edhe në Mal të Zi kanë mbaruar afatet dhe do isha i lirë edhe nëse do isha ekstraduar.

A keni komunikuar me avokatët, çfarë ju thonë?

As avokatët nuk po bëjnë gjë. Nuk ka asnjë lëvizje. Avokati i Popullit ka folur me Ministrinë e Drejtësisë dhe ka thënë në qoftë se malazezët nuk vijnë ta marrin për ekstradim, nuk lirohet.

Keni familje?

Kam bashkeshorten në Mal të Zi që më pret dhe është e shqetësuar. Nuk e takoj prej muajsh, vetëm kam folur në telefon.

Keni pasur probleme në burg?

Jo nuk kam pasur, por kërkoj të zbatohet vendimi.

AKUZA PËR MASHTRIM

Maxim Barycaun dhe deklaroi për "BalkanWeb" se është akuzuar për mashtrim. Ai pohoi se edhe në Mal të Zi kanë mbaruar afatet dhe se tani do të ishte i lirë edhe nëse do ishte ekstraduar. "As avokatët nuk po bëjnë gjë. Nuk ka asnjë lëvizje. Avokati i Popullit ka folur me Ministrinë e Drejtësisë dhe ka thënë në qoftë se malazezët nuk vijnë ta marrin për ekstradim, nuk lirohet", pohoi 36-vjeçari nga Bjellorusia.

Cili është apeli juaj?

Më kanë anashkaluar institucionet. Dua të drejtat e mia. Po nuk më dhanë zgjidhje do i bëj ndonjë gjë vetes.

BASHKËSHORTJA

Ndërkohë "BalkanWeb" ka komunikuar edhe me bashkeshorten e 36-vjeçarit, shtetasen Oksana Ushakova, e cila nga Mali i Zi kërkon ndihmë, pasi sipas saj është e

Ja dy njoftimet e Policisë së Shtetit për ekstradimin dhe ndalimin e bjellorusit

TIRANË - Policia shqiptare ka pasur dy njoftime zyrtare për shtetasin bjellorus Maksim Barycaun. Në njoftimin e parë thuhet se më 24 gusht 2017 u ekstradua nga Indonezia shtetasi në fjalë pasi Gjykata e Krujës ka caktuar masën e sigurisë "arrest në burg" për "Mashtrim".
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoritë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë



Komisariati i Kufirit dhe Migracionit Rinas

Më datë 24.08.2017, në Aeroportin "Nënë Tereza", u ekstradua nga Indonezia, shtetasi bjellorus në kërkim ndërkombëtar M.B, vjeç 34,

pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Mashtrimi". Neni 143 i Kodit Penal.
NJOFTIMI I DYTË MË 9 TETOR 2019
Më datë 09.10.2017, u ndalua shtetasi në kërkim M.B, vjeç 34 banues në Bjellorusi, pasi Gjykata e Apelit Tiranë, ka dhënë masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Mashtrimi" më shumë se një herë " Neni 143/2 i Kodit Penal.

paligjshme që bashkeshorti të mbahet ende në burg. "Burri im u arrestua më 10 qershor 2017 në Indonezi, dhe Interpoli e ktheu në Shqipëri! Në këtë rast nuk ka një kërkës të vetme dhe viktimë, por atij iu dha një dënim maksimal. Më pas

Gjykata Supreme e përbys dënimin e tij duke i dhënë 1.5 vjet, dënim që ka mbaruar. Ai duhet të ishte liru që më 6 dhjetor ose duhet të ishte ekstraduar në Mal të Zi. Por ai nuk është liru. Burri im hyri në grevë urie për 10 ditë.

Asnjë reagim. Tani ai më ka thënë se do presë damarët. Jam shumë e shqetësuar. Ndërkohë që administrata i thotë se do të çojmë në një spital mendor. Ata tallen me burrin tim", tregoi gruaja e tij Oksana për "BalkanWeb".

Sinjalizuan qytetarët, kapen 3 shpërndarësit e drogës në Memaliaj

GJIROKASTËR - Tre persona janë arrestuar nga policia e Gjirokastrës, pasi akuzohen për shpërndarje droge. Policia pas një informacioni të marrë nga qytetarët për disa shtetas qytetarë për disa shtetas qytetarë në doza të vogla në zonën e Memaliajt, ka organizuar punën për evidentimin dhe goditjen e tyre. Blutë e Gjirokastrës në bashkëpunim me forcën e posaçme "Shqiponjat", kolegët e Tepele nës dhe Memaliajt, kanë ushtuar kontrolle në aksin rrugor Memaliaj-Luftinjë, ku si rezultat i kontrolleve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: L.C., 28 vjeç; N.K, 21 vjeç dhe F.C. 43 vjeç, banues në Xhafaj e Derwishaj, të Bashkisë Memaliaj. Mësohet se gjatë kontrollit të shtetasve L.C. e N.K. që udhëtonin së bashku në një automjet, si dhe shtetasit F.C. që udhëtonte në automjetin e tij, iu gjetën dhe sekuestruan më cilësinë e provës materiale 100 doza me lëndë narkotike cannabis sativa. Materialet në ngarkim të 3 personave në fjalë iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për veprën penale: "Prodhim dhe shitje të narkotikëve".

Analiza e policisë, të goditen grupet kriminale

Ekzekutimet e bujshme në Shkodër, Ardi Veliu kritikon vartësit: Zbardhni ngjarjet e 2018-ës

SHKODËR - Kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu ka kritikuar punën e policinë vendore të Shkodrës në analizën një vjeçare të 2018-ës. Viti që lëmë pas ishte ndër më të vështirët për blutë e qytetit verior, pasi u shënuan disa vrasje të bujshme të njëpasnjëshme që erdhën pas një riaktivizimi të botës së kriminit. Ngjarjet e vitit të kaluar me vrasje dhe zhdukje personash kanë bërë që drejtori Veliu të jetë kritik në analizë. Pas analizës që zgjati për rreth 3 orë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk preferoi që të

ANALIZA

Në analizën njëvjeçare fillimisht drejtori i policisë Shkodër Vehbi Bushati ka lexuar një material të gjatë dhe më pas fjalën e ka marrë Drejtori i Përgjithshëm, Ardi Veliu duke kërkuar më shumë rigorozitet nga efektivet si dhe në fokus sipas tij, duhet të jetë lufta ndaj kriminit të organizuar, rikthimi i besimit tek qytetarët si dhe një efikasitet më e madhe e policisë.

japë asnjë deklaratë pavarësisht këmbënguljes së mediaeve. "Më mirëkuptoni unë nuk isha përgatitur për një prononcim për mediat", ka thënë shkurt ai. Kritikat e kreut të policisë, Veliu i pranoi edhe vetë drejtori i policisë vendore

në Shkodër, Vehbi Bushati, i cili tha se Drejtori i Përgjithshëm ka kërkuar punë nga policia e Shkodrës që nënkupton një luftë më të madhe ndaj kriminit dhe çdo aspekti tjetër. Mbaruan analizën 1-vjetore. Drejtori i Përgjithshëm i Poli-



Kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu

cisë së Shtetit bëri vlerësimë bëri edhe kritika, por ashtu la edhe detyra. Viti që vjen do të jetë një vit akoma më i angazhuar për policinë për t'u sjellë rend dhe qetësi në funksion të qytetarëve të Shkodrës dhe njëkohësisht ne do fitojmë besimin e tyre për të qenë më afër tyre dhe për të zgjidhur problemin e tyre. Ai

kërkoj punë dhe rezultate konkrete në goditjen e elementëve kriminalë në Shkodër", tha Bushati. I pyetur nëse është kërkuar zbardhja e ngjarjeve kriminale të ndodhura në 2018-ën në Shkodër drejtori Bushati tha se nuk kishte një koment tjetër për të bërë. "No koment", u përgjigj ai për gazetaret.

Policia arreston autorin 31-vjeçar, Esat Cani, kunatin dhe 20-vjeçarën

Zbuloi lidhjen jashtëmartesore të motrës, vëllai i masakron të dashurin

34-vjeçari Arben Gjeci u gjet pa ndjenja në rrugë, humbi jetën në Spitalin e Traumës

TIRANË

Një 34-vjeçar, i cili ndërroi jetë të premtën në Spitalin e Traumës në Tiranë mësohet se është vrasë me mjete të forta nga vëllai i të dashurës së tij. Viktima është Arben Gjeci nga fshati Bastar i Mesëm, i cili u gjet i plagosur në kokë në anë të rrugës nga kalimtarët mbrëmjen e së enjtes dhe u transportua menjëherë në spital, por nuk arriti t'u mbijetonte plagëve të marra. Fillimisht ngjarja u raportua si aksidentale, por hetimet provuan të kundërtën. Pas kryerjes së veprimeve hetimore ka rezultuar se lidhja me një 20-vjeçare të martuar i kushtoi jetën Gjecit, baba i 3 fëmijëve. Sipas burimeve nga policia, lidhja jashtëmartesore e së resë është zbuluar nga bashkëshorti dhe vëllai i saj. Dyshohet që 34-vjeçari është goditur me shufër hekuri në një kasolle dhe me pas është hedhur në rrugë. Pas zbardhjes së ngjarjes së rëndë, blutë e kryeqytetit arrestuan autorin e dyshuar të ngjarjes, Esat Cani, 31 vjeç, i cili akuzohet për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen"; motrën e tij, E. Cani si dhe bashkëshortin e kësaj të fundit, 29-vjeçarin me inicialet Dajet Kurti për veprën penale: Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".



Fshati Bastar i Mesëm ku ndodhi vrasja



ka rënë nga një lartësi. Nisur nga plagët e shumta, policia është thelluar në hetime për të zbuluar shkaktuesin e vërtetë të vdekjes. "Pas një pune intensive dhe të pandërprerë 48 orëshe, policia e Tiranës në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka zbardhur rrethanat dhe arrestuar 3 persona, për një ngjarje të raportuar në nisë si një vdekje aksidentale. Dyshohet se shtetas E.C., më datë 24 janar 2019, rreth orës 20:30, në fshatin Bastar i Mesëm ka goditur me sende të forta në kokë shtetasin A.G., 34 vjeç, duke i shkakuar dëmtime të rënda në kokë. Për pasojë i riu humbi jetën në Spitalin e Traumës. Ngjarja u raportua si aksidentale. Por hetimet provuan të kundërtën. Në polici u shoqëruan disa shtetas dhe u kryen disa veprime

PERSONAT E ARRESTUAR PËR VRASJEN E 34-VJEÇARIT

1. Esat Cani, 31 vjeç, i akuzuar për veprën penale: "Plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen"
2. Dajet Kurti, 29 vjeç, i akuzuar për veprat penale: "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike"
3. E. Cani, 20 vjeç, e akuzuar për veprën penale: "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës"

komplekse hetimore në konfidencialitet të plotë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Po sipas bluve, "në vijim të këtyre veprimeve, dyshohet se shtetas D.K., dhe E.C., me veprimet dhe mos veprimet e tyre kanë fshehur të vërtetën e ngjarjes së ndodhur. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në banesë u gjet edhe një sasi

lëndë e dyshuar kanabisi. Shërbimet e Policisë Tiranë bënë arrestimin e shtetasve: E.C., 31 vjeç, për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen"; D.K., 29 vjeç, për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike" dhe E.C., 20 vjeç, për veprën penale

"Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Ndërkaq, burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se mbrëmjen e së enjtes, Arben Gjeci është takuar me 20-vjeçarën pranë banesës së familjes Cani në fshatin Bastar i Mesëm. Ndërkaq, vëllai i saj, Esat Cani dhe bashkëshorti, Dajet Kurti e kanë ruajtur dhe i kanë gjetur të dy në një kasolle pranë shtëpisë. Ata i ruajtën, pasi më herët burri i 20-vjeçarës e ishte ankuar kunatit se motra e tij e tradhëtonte. Lidhja jashtëmartesore nuk është pranuar nga vëllai i 20-vjeçarës, i cili ka marrë një hekur dhe e ka goditur disa herë në kokë Arben Gjecin, i cili ka humbur ndjenjat. Më pas, dy agresorët e kanë nxjerrë 34-vjeçarin nga kasollija dhe e kanë lënë në rrugë ku dhe u gjet nga banorët e zonës.

SHKURT

Digjen tri makina të biznesmenit në Ujë të Ftohtë

VLORË - Qyteti i Vlorës është zgjaur sërish mëngjesin e djeshëm me djegie makinash. Tre automjete në pronësi të një biznesmeni janë përfshirë nga flakët në zonën e Ujit të Ftohtë. Mësohet se mjetet ishin të parkuara poshtë pallatit ku jetonte biznesmeni. Sipas burimeve policore, se flaka u vu fillimisht një makine "Smart", ndërsa më pas u përfshinë nga zjarri edhe dy automjet të tjera, të markave "Audi" e "Landrover". "Më datë 26.01.2019, rreth orës 01:58, në lagjen "Ujë i Ftohtë" automjeti tip "Smart" ka marrë flakë, ku si pasojë e flakëve janë djegur pjesërisht edhe 2 automjete të tjera të markave "Audi" dhe "Landrover" në pronësi të shtetasit E.H. Grupi hetimor po vijon punën për përcaktimin e shkakut të rënies së zjarrit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Pas ngjarjes, blutë kanë marrë në pyetje pronarin e tre automjeteve dhe të tjerë persona që mund të kenë dijeni për këtë rast.

Gjendet i vdekur ish-karabinieri

italian, Fausto Bistri GIROKASTËR - Një shtetas italian është gjetur pa jetë në lagjen "Manalat" në Gjirokastrë. Bëhet fjalë për 74-vjeçarin e identifikuar si Fausto Franko Bistri, me leje qëndrimi në Shqipëri, Gjirokastrë. Mësohet se viktimi ka qenë karabinier, por tashmë në pension. Po kështu bëhet e ditur se 74-vjeçari bashkëjetonte prej tre vitesh me një shtetas shqiptar rreth 40 vjeç. Nuk dihen ende motivet zyrtare të vdekjes, por dyshohet se vdekja e të moshuarit ka ndodhur për shkaqe natyrore.

Konflikti, 39-vjeçari nxjerr pistoletën dhe qëllon në ajër

TIRANË - Një 39-vjeçar është arrestuar për veprat penale "Kanosje" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak" në kryeqytet si dhe i është sekuestruar një armë zjarri "pistoletë". Shërbimet e Policisë së Komisarariatit Nr.3 thonë se ky shtetas në rrugën "Zydi Herri", pas një konflikti ka kanosur tre shtetas duke qëlluar në ajër me armë zjarri "pistoletë", e cila u sekuestrua në cilësim të provës materiale. Materialet procedurale i kaluan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërsa, pritet që gjykata e të vendosë masën e sigurisë ndaj 39-vjeçarit.

LIGJI I RI I PPP-ve



Gjergj Buxhuku, kreu i Konfindustrië

Konfindustria: Ndryshimet të pamjaftueshme

Konfindustria i vlerëson të pamjaftueshme ndryshimet e propozuara në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik-privat. Me një deklaratë për mediat, shoqata e bizneseve prodhuese shpreh se ndërhyrjet e parashikuara në projekt ligj janë të paplota dhe sërish lënë hapësira të shumta për subjektivizëm, korrupsion dhe shpërdorim të parave publike. Heqja e propozi-

meve të pakërkuara vetëm në projektet e infrastrukturës rrugore dhe lënia hapur e mundësive për sektorët strategjikë të ekonomisë si energjia, portet, aeroportet, etj. rrezikojnë ta kthejnë projekt ligjin vetëm në një retorikë politike pa asnjë ndikim të prekshëm. Konfindustria vlerëson, se Shqipëria është e papërgatitur në infrastrukturën institucionale të domosdoshme për

ndërtimin dhe zbatimin e politikave të PPP, që janë mjaft të ndërlikuara dhe problematike edhe për vende të zhvilluara. Për sa më sipër do të kërkohet, që në një afat kohor, deri në përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme, politikave të PPP dhe koncesioneve të pakërkuara duhet të ndërpritet menjëherë dhe pa kufizim sektorësh. Gjithashtu, Konfindustria shpreh se

është e papranueshme, që në draftin e paraqitur përsëri nuk ndalohej në mënyrë të prerë pjesëmarrja në kontrata koncesionare dhe PPP të kompanive "guaskë" të regjistruar në parajsa fiskale, pavarësisht dëmit të madh ekonomik, financiar, moral të sjellë ndaj interesit publik dhe seriozitetit të vendit në afatgjatë. Sipas Konfindustriës, politikat e PPP-ve rrezikojnë drejtpërdrejt dhe afatgjatë treguesit makroekonomikë të vendit.

Sot afati i fundit për aplikimet, procedurat dhe dokumentet për të fituar vendin e punës

Në administratë, 803 vendet e punës për studentët, ja si do të ndahen

Tiranë do të jenë plot 440 vende të lira

Sot është afati i fundit për studentët, të cilët dëshirojnë të aplikojnë për t'u punësuar pranë administratës publike. 27 janari është data që qeveria ka vendosur afatin e fundit për aplikim duke ofruar për këtë vit 803 vende pune në total pranë administratës publike për studentët, të cilët janë ekselentë. Në shërbimin civil pritet të punësohen 601 studentë dhe 202 punësime të tjera me kod pune. Të rinjtë, të cilët do të aplikojnë këtë vit do të rekrutohen pa kaluar në proceset e konkurrencës, ndryshe nga sa ndodhte më parë. Studentët do të kenë mundësinë e përzgjedhjes për vendet e punës dhe ky proces do të varet nga mesatarja e gjithsecilit, prioritet pritet të kenë ata student të cilët kanë mesatare më të lartë. Aplikimet për punësim priten të rihapen sërish brenda vitit. Punetëmbare.al është portali i vënë në dispozicion për të gjithë studentët të cilët dëshirojnë që të punësohen në administratë.

ADMINISTRATA

Departamenti i Administratës Publike ka njoftuar ndarjen e 803 vendeve të punës për studentët mbi bazë qarku. DAP njofton se pozicionet vakante për 803 vendet e punës sipas vendbanimit do të jenë përkatesisht: 19 vende vakante në Qarkun e Beratit, 9 vende vakante në Qarkun e Dibërës dhe 45 vende vakante në Qarkun e Durrësit. Duke vazhduar më tej me 35 pozicione të lira në Qarkun e Elbasanit, 50 vende punë të lira në Qarkun e Fierit, 12 vende të lira në Qarkun e Gjirokastrës dhe 39 pozicione të lira në Qarkun e Korçës. Në Qarkun e Kukësit pozicionet vakante sipas lajmërimit të DAP do të jenë 24, pasur nga Qarku i Lezhës me 15 vende pune të lira dhe Qarku i Shkodrës me 67 vende të lira. Sipas njoftimit në Tiranë do të jenë plot 440 vende pune të lira për studentët ndërsa në Qarkun e Vlorës do të jenë të lira 48 vende pune. Për vitin 2019, pozicionet vakante specialist dhe të



Foto ilustruese

APLIKIMI

- a) Pozicionet vakante, të grupuara bazuar në kriterin e nivelit dhe llojit të diplomës (fusha e studimit) që kërkon pozicioni i punës;
- b) Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
- c) Mënyrën dhe afatin e dorëzimit, të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- d) Mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve;
- e) Datat e daljes së rezultateve;
- f) Mënyrën e njoftimit dhe të komunikimit me kandidatët.

EKSELENTËT

"Studentët të ekscelencës" janë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të arsimit të lartë me mesatare 9.00 - 10.00 ose ekuivalente, në: institucionet e ar-

simit të lartë jashtë Shqipërisë; institucionet e akredituara të arsimit të lartë publik apo institucionet /programet e akredituara të arsimit të lartë jopublik në Republikën e Shqipërisë. Procesi i përzgje-

PROCEDURAT

- **DOKUMENTET**
Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Kryeministriës apo ministriës që ka bërë shpalljen publike në mënyrën e përcaktuar në të, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në faqen përkatese zyrtare.
- **PËRZGJIDHJA**
E drejta e përzgjedhjes është sipas precedencës, si më poshtë vijon:
a) Studentët e diplomuar në institucionet e arsimit të lartë në një nga vendet anëtare të OECD-së ose BE-së;
b) Studentët e diplomuar në institucionet e akredituara të arsimit të lartë publik në Shqipëri;
c) Studentët e diplomuar në institucionet/ programet e akredituara të arsimit të lartë jopublik në Shqipëri dhe studentët e diplomuar në vende të tjera jashtë Shqipërisë, të ndryshme nga vendet e OECD-së ose BE-së. Diplomata e përfuturuar jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas legjislativonit në fuqi.
- Në rastet e studentëve me mesatare të njëjtë, e drejta e përzgjedhjes përcaktohet me short në prezencë të tyre. Kryeministria/ministritë, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i procesit vendimi:
a) publikojnë në faqen e tyre zyrtare listat e studentëve që kanë përzgjedhur pozicionet e punës;
b) dërgojnë pranë institucioneve të tyre të varësisë listat e studentëve të cilët kanë përzgjedhur pozicionet e punës për secilin institucion.

dhjes dhe emërimit menaxhohet nga Kryeministria, ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë. Sipas VKM-së Kryeministria dhe ministritë e linjës shpallin publikisht në faqen e tyre zyrtare, thirrjen për

shprehjen e interesit të studentëve të ekscelencës që duan të punësohen përkohësisht në institucionet e tyre të varësisë, sipas kërkesës së këtyre të fundit, përkatesisht brenda muajit janar 2019 dhe muajit gusht 2019.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja B, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 22.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lartë për shijen e pasurisë së paluajtshme. Anë, me sipërfaqe 13,000 m². Nr. pasurie 38/10, Zona Kadasrale Nr. 1659, Vol. 5, Fq. 202, në pronësi të: Z. Behar Ibrahim, Flamur Ibrahim, Arben Ibrahim, Eduart Ibrahim, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 98,280 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme, Anë, me sipërfaqe 8,200 m². Nr. pasurie 6/4, Zona Kadasrale Nr. 1659, Vol. 4, Fq. 34, në pronësi të: Z. Fatmir Kazi, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 115,300 (Njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja B, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 16.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lartë për shijen e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap. 13 Durrës, në pronësi të Z.Çlirim Sejfulla Xhafa dhe Znj. Bardha Xhema Xhafa me vlerë fillestare në ankand 32,468 (Tridjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare "bën bilancin" për kompanitë e sigurive për vitin 2018

Dëmet e prapambetura, u paguan shtatë miliardë lekë në një vit

Rriten të ardhurat nga primet, shlyhen edhe detyrimet

Kompanitë e siguri meve paguan mbi 7 miliardë lekë dëme të prapambetura gjatë vitit 2018. Sipas të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dëmet e bartura në vitin në Fondin e Kompensimit të Byrosë së Sigurimeve janë shlyer në pjesën më të madhe të tyre. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndaj Byrosë së Sigurimeve ka sjellë një rritje të ndjeshme të dëmeve totale të paguara. Gjatë vitit 2018, siguruesit paguan afro 7 miliardë lekë dëme, në rritje me 26% krahasuar me vitin 2017. Raporti mes dëmeve dhe primeve ka arritur në 41%, një ndër më të lartët e regjistruar ndonjëherë në tregun shqiptar të sigurimeve. Presioni i AMP-së dhe Komisionit të Ekonomisë më në fund duket se ka sjellë rezultate në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të Fondit të Kompensimit. Në dy vjet, kompanitë kanë paguar rreth 1.7 miliardë lekë dëme.

ZHVILLIMI I TREGUT

Tregu i sigurimeve shfaq një rritje modeste edhe vitin e kaluar. Primet e shkruara bruto u rritën me 4.5% krahasuar me një vit më parë. Në veçanti, tregu i sigurimit të jetës rezultoi në rënie me 4.5%. Shqiptarët paguanjesh mesatarisht rreth 45 euro prime sigurimi për frymë, vlerë kjo më e ulët krahasuar qoftë edhe me vendet fqinje. Peshja e sigurimeve të detyrueshme u thellua edhe më shumë këtë vit, duke e bërë tregun gjithnjë e më të



Foto ilustruese

varur prej tyre. Sigurimet e detyrueshme motorike sollën mbi 68% të primeve të arkëtuara nga kompanitë vitin e kaluar. Edhe në tregun e sigurimit të jetës më shumë se gjysma e primeve erdhën nga sigurimi i jetës së debitorit, sigurim ky që kërkohet në mënyrë të

detyrueshme nga institucionet financiare.

TË ARDHURAT

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2018 kapën vlerën mbi 16,921 milionë lekë, ose 4.49% më shumë se në vitin 2017. Gjatë vitit 2018, numri i kontratave të sigurimit të

lidhura arriti në 1,309,143 me një rritje prej 5.89% krahasuar me vitin 2017. Tregu vazhdoi të mbetet sërisht i orientuar tek sigurimet e Jotjes, të cilat sollën 92.93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatesisht sigurimet e Jetës me 6.75% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.32%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.59% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.41% të totalit të tregut. Gjatë vitit 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,972 milionë lekë, ose 26.23% më shumë se në vitin 2017.

SHKURTE

Hetimi tatimor verifikon bizneset me risk

Drejtorja e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve po vijon punën në terren për verifikimin e të gjitha subjekteve me risk. Kontrolli i tatimpaguesve që ushtrojnë veprimtari në qendrat e qyteteve kryesore në vend, në zonat me aktivitet të lartë si dhe në tregje do të jenë edhe fokusi i punës së strukturave hetimore. Garantimi i përmbushjes vullnetare dhe zbatimi i legjislacionit tatimor, kontrolli i tatimpaguesve që rezultojnë me rënie të xhiros, krahasuar me një vit më parë, si dhe fatmirimi dhe lëshimi i kuponit tatimor janë edhe objektivat kryesorë të Hetimit Tatimor Administrata Tatimore në asnjë rast nuk ka si qëllim ndëshkrimin e tatimpaguesve, por ndërgjegjësimin e tyre për vetëdeklarimet dhe përmbushjen me korrektesë të detyrimeve tatimore.

Hapet autostrada Tiranë - Durrës, qarkullimi me dy kors

Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se prej orës 17:30 të pasdites së djeshme qarkullimi nga Durrësi në drejtim të Tiranës bëhet normalisht pas përfundimit të punimeve për vendosjen e ndarësve mes korsive. Nderkohë që nesër do të punohet në sensin nga Tirana në drejtim të Durrësit dhe qarkullimi do të bëhet me një kors. "Përfundimi vendosja e barrierës mbrojtëse - guardrele tek Fordi km 7.3. Sot në orën 17:30 hapet rruga dhe qarkullimi i mjeteve bëhet me 2 kors në drejtim të Tiranës. Nesër datë 27.01.2019 në orën 8:00 vijon puna për vendosjen e guardrelave tek City Park km 8.6 në autostradën Tiranë-Durrës dhe kalimi i mjeteve në drejtim të Tiranës do të jetë përsëri me një kors në këtë pikë të rrugës" njofton ARRSH-ja. Kjo është ndërhyrja e tretë që bëhet në autostradën Tiranë-Durrës brenda pak muajve, pasi në verë u bë riparimi i shtresave asfaltike, në fillim të këtij viti u vendosën tombinat për të shmangur përmblytjet, ndërsa tashmë po vendosen ndarëset.

Bizneset e mëdha çlirohen nga kamatëvonesat

Ndryshimet në paketën fiskale, dy lehtësira për biznesin VIP

Ndryshime e reja fiskale për vitin 2019 parashikojnë dy procedura lehtësuese për biznesin, në rast ai do të ankimojë një vendim të administratës tatimore. Drejtorja e drejtorisë së VIP-ave në administratën tatimore shpjegon se nuk do të paguhet më kamatëvonesat, në rast të një apelimi vendimi, por vetëm detyrimi, ndërsa gjoha do të ulët në 70% të vlerës, në rast se subjekti pranon vlershmin e përcaktuar nga tatimet. Ndërsa kush do të përfitojë nga dividendi në masën 8%, për vitet para 2018, bizneset do të duhet ta paguajë atë brenda datës 30 shtator. Pas këtij afati ky tatim për vitet paraardhëse do të jetë 15%. Paralelisht me këto ndryshime, në fuqi kanë hyrë edhe dy masa antievazion. Subjektet nuk mund të kalojnë në status pasiv, pa paguar më parë detyrimet, ndërsa një person fizik nuk mund të regjistrohet me disa nipte duke ndarë aktivitetin e tij.



KAMATVONESAT

Drejtorja e drejtorisë së VIP-ave në administratën tatimore shpjegon se nuk do të paguhet më kamatëvonesat, në rast të një apelimi vendimi, por vetëm detyrimi, ndërsa gjoha do të ulët në 70% të vlerës, në rast se subjekti pranon vlershmin e përcaktuar nga tatimet.

Njoftim për shitje me ankand te trete

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nënlet 577, 568 të K.Pr.Civile ka shpallur në datë 21.01.2019 shlyerjen me ankand te trete të pasurisë palës debitore, hipotekuese dhe palës dorëzuese.
 ■ "Toka Are" në Z.K.1987 me numër pasurie 30/38 Volumni 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2. Lezho me cmim fillësar prej 52,214.4 Euro
 ■ "Toka Are" në Z.K.1987 me numër pasurie 40/56 Volumni 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 Lezho me cmim fillësar prej 90,331.2 Euro
 ■ "Toka Are" në Z.K.1987 me numër pasurie 25/73 Volumni 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2,000 m2 Lezho me cmim fillësar prej 88,301.8 Euro
 Ankandit qendron i hapur për 30 ditë dhe do të zhvillohet në datën 20.02.2019 në orën 15:00, në sallën tona Buletin 'Gj. Fishtar' Kallë 1, Kat 2 Zyrat nr. 5 kontakto 0472082543 ose email ar_drejtoria@yaho.com dhe ne WEB www.powerjustice.al.com.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe siguracioni i shëndetit në udhëtim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **71,082,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparkisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkrahimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe siguracioni i shëndetit në udhëtim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **18 Shkurt 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


Opinion i Ditës

Historia ka nevojë për modele... ne duhet ta njohim atë

Nga Përparim Kabo

U mbushën 100 vite që zemra e tij pushoi. Po në këtë shekull ull vepra e tij është prezente. Personaliteti tij nuk është zbehur, kontributi rimerr gjithnjë e më shumë rëndësi historike. Ne nuk mund ta ngjallim Ismail Qemalin si njeri. Ne kemi për detyrë kombëtare dhe shkencore të mos lëmë të harrohet, përdhoset apo më keq akoma të sulmohet kontributi i tij historik pa të drejtë dhe jashtë argumenteve shkencore. Ai duhet vlerësuar si një model ku ne duhet të referohemi. Më lejoni të parashtoj disa ide të filozofisë-antropologjike, në lidhje me sjelljen dhe kontributin në histori, se si duhet gjykuar historia dhe në ç'raporte është ajo me politikën. Si vlerësohen personalitetet historike dhe si edukohet kombi në vijmësi me shembullin e kontribuesve të shquar të historisë së vetë. Pse dhe çfarë përfohet kur studiojmë historinë? Shpesh themi që ngjarjet historike dhe sjellja ndaj tyre kushtëzohen, po nga çfarë faktorësh?

Profesor Burrhus Frederic Skinner një personalitet i Harvardit studiues i rreptë për sjelljen, besonte se: "Mjedisi është i vetmi përgjegjës për të gjithë sjelljet". Ai arrin në këtë përfundim duke përfshirë modelet e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të sjelljes të studiuar nga teoricienët e personalitetit. Në kontrast me idenë e Skinner që mëtonte se vetëm mjedisi përcakton sjelljen, profesor Albert Bandura nga universiteti Stanfordit në vitin 1990 propozoi konceptin e determinizmit reciprok, sipas të cilit të gjithë faktorët ndërveprojnë. Si të tillë ai rreshton proceset njohëse, sjelljen dhe kontekstin, duke argumentuar se secili faktor ndikon dhe ndikohet nga të tjerët në të njëjtën kohë. Me procese njohëse ai ua referohet të gjitha karakteristikave të mësuara më parë, (lexojë njëjtë kaluarën) përfshirë bindjet, prirjet dhe karakteristikat e personalitetit. Sjellja sipas tij edhe ajo politike; i referohet çdo gjëje që ne bëjmë dhe që mund të shpërblehet ose të ndëshkohet. Përfundimisht, konteksti në të cilin ndodh sjellja i referohet mjedisit ose situatës, që përfshin stimuj të shpërblimit apo ndëshkimit, prirjet pohuese dhe kundërshtitë. Nëse duhet të gjykojmë sot; çfarë ndodhi në 28 nëntorin e 1912-s me shpalljen e pavarësisë së vendit, na duhet të mbajmë parasysh edhe këto kritere shkencore. Së paku në geometrimë e trinomit njohje-sjellje dhe konteksti historik. Akti duhet të vlerësohet si vendim që u morr nga nja ansamble kombëtare, sepse përfaqësimi ishte nga të gjitha trevat shqipfolëse, në të



katër vilajetet. Shpallja e pavarësisë duhet konsideruar si dalje nga sundimi Osman, si krijim i shtetit shqiptar me simbole dhe me organet (mbetej pezull çështja e territorit së paku deri në vendimet përfundimtare të Konferencës së Londrës;) por është rasti të themi edhe nja dy argumente me shumë rëndësi. Me aktin e 28 nëntorit të 1912-s dhe me vizionin që kishte Ismail Qemali për orientimin nga Europa si zhvillim dhe kulturë, sepse, siç pohonte Ai, si racë dhe komb ne i takonim kontinentit të vjetër përcaktohej drejtimi i zhvillimit; u realizuan shkëputja nga orientalizmi dhe riniste orientimi vendit nga perëndimi, rifuteshim në udhën për rigjetjen e identitetit historik të humbur. Me aktin e pavarësisë kishte nisur largimi nga feudalizmi dhe hyrja në udhën e kapitalizmit dhe të zhvillimit borgjez. Ja përse në gjykimin tim Ismail Qemali është i pari kryeministër europianist i Shqipërisë së paku që nga koha e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut, cili me rezistencën e tij antiosmane kishte orientim Europen dhe krishterimin. Edhe duke i rreshtuar si fakte këto detyra historike ne e kuptojmë se çfarë barre të rëndë kishte vënë historia para atyre burrave. Në atë datë historike nisi ndryshimi, i cili për fatin tonë vazhdon, sepse ende si shoqëri ne nuk kemi zbrazur nga orientalizmi dhe nuk kemi përfshirë tërësisht në kulturën iluministe dhe europianiste; pa çka se kemi një shtet me sistem të

demokracisë kolektive përfaqësuese. Ka studiues, por dhe profanë, të cilët mendojnë se pavarësia me atë kosto territoriale nuk duhej pranuar, ose si thoshte Baron Ferenc Nopce, "foshnja kishte lindur e vdekur" kur më 1913 u morën Kosova edhe Çamëria. Ka që mendojnë se po ta kishim marrë pavarësinë disa vite më vonë, pra kur ra perandoria Turko-Osmane në 1919-n, do kishte qenë më mirë, sepse mund të kishim marrë të gjithë territorin natyror. Po është fakt që në 1878-n Lidhja e Prizrenit por dhe Britania e Madhe flisnin për një shtet shqiptar me të katër vilajetet. Citoj... "Për faktin se Perandoria Osmane tashmë i kishte ditët e numëruara, ndërkohë që telasht që ajo linte prapa, nuk përjashtonin edhe çështjen shqiptare... fuqitë europiane shtetin shqiptar kishin filluar ta projektonin si një faktor... siç do të veprojnë Anglia, e cila do ta autorizojë Lordin Edmond Fitzmaurice, që në përputhje me artikujt XVIII dhe XXIII të Kongresit të Berlinit, Portës t'i kërkojë që të krijojë një Shqipëri autonome në një vilajet që do të bashkonte vilajetet e Shkodrës, Janinës, Kosovës dhe Manastirit, që do të mbetej në suzerenitetin e Sulltanit." Këtë fakt e përmend historiani gjerman Hanns Dieter Schandler kur analizon dokumentin e Forin Officit të 26 majit 1880 dhe takimin e Lordit Fitzmaurice me ministrin e jashtëm turk Sawa Pashën." Por ja që po kjo Angli në 1913, 1915 u soll

ndryshe dhe korrigoj në 24 mars 1999 kur bombardoi bazat ushtarake serbe dhe njohu Kosovën në 2008-n. Po kështu ShBA-ja, e cila para ndoca ditëve shkoi edhe më tej, organizoi diskutim në senat për Çamërinë. Kush nga ata që firmosën pavarësinë nuk e donte Shqipërinë natyrale?! Ismail Qemali nuk e donte?! Unë gjykoj se sot diskutime të tilla janë hipotetike dhe që nuk sjellin dobi as në rrafshin shkencor dhe as në atë historik. Nëse mbetemi peng i tyre do gabojmë në shumë plane, qoftë në atë të vlerësimit korrekt të ngjarjeve dhe personaliteteve por edhe në sjelljen tonë në ditët kur jetojmë. Diakronia nuk është e mjaftueshme për ta ribërë historinë e aq më shumë vlerësimin e saj përmes historiografisë së shkruar apo më keq akoma me hamendësimet. Ka dhe një pyetje logjike pezull. Nëse ka nga ata që nuk janë dakord me atë që u bë ose janë të kënaqur pjesërisht, le të na argumentojnë se ku e kanë atë garancinë që po të veprohej ndryshe do kishim përfundime tejet më të favorshme se ato të 28 Nëntorit 1912-s? Provat për ngjarjet historike nuk bëhen as në laboratore as në arsyetimet teorike. Në thebin e historisë së gjallë janë ngjarjet që nuk përgatiten në një ditë qoftë si mendësi, qoftë si veprime shoqërore qoftë si vendimarrje konkrete. Ato kulmojnë në një ditë ashtu si njeriu, i cili lind në një datë, por që fillimisht ngjizet në ëndrrat e adultëve dhe më tej

mbillet ne fetusin e nënës dhe pret deri sa të dali në jetë. Edhe ngjarjet kulmore historike janë të lidhura me rrenjë, kushtet, zhvillimet, rrethanat, gjendjen përgjithshme dhe befasitë shpesh koniukturale rajonale dhe globale. Kujtesa historike nuk ndërtohet as me akuzë dhe as me mohime, por as edhe vetëm me lavdërime dhe mbyllje sysh para gabimeve apo veprimeve të pamatura që mund të kenë ndodhur rrjedhave të historisë. Ne kemi nevojë si shoqëri të dalim nga ajo gjendje acide e urrejtjes dhe sulmeve brenda vetes sepse shpesh keqkuptimet në vlerësimin dhe gjykimin e historisë nuk na vijnë nga jashtë, por nga brenda. Fatkeqësisht jemi po ne që hedhim gurë mbi historinë tonë dhe ndaj njerëzve të shquar e me kontribut. Mua më parapëlqen të përsëris atë që thoshin gjëbrenjtë e vjetër: "Kujtesa ka gjithmonë të drejtë". Le ta rimarrim të moduluar këtë postulat: "Kujtesa jep drejtësi nëse e pranojmë të gjithë si autoritetin e baraslarguar". Shqetësohen disa kur përmendet se krah Ismail Qemalit në atë akt sublim të hartimit të deklaratis së pavarësisë dhe firmëtarë të saj, ishin edhe Lef Nosi, Mustafa Kruja e Mit'hat Frashëri, etj; duke sjellë si argument mohues një pjesë të sjelljes së tyre historike që do të vinte disa dekada më vonë. Ky qëndrim ndaj historisë që shpesh shkon deri në pikën fundore të denigrimeve, është më shumë pasion dhe jo arsye, është duf dhe jo argument. Urrëjtja nuk e ndihmon shkencën e historisë dhe nuk të qas te e vërteta por të mban peng të gjysmë të vërtetave apo edhe aspak të vërtetave.

Nëse njerëzit e mëdhenj jetuan jetën e tyre duke përmbushur çka kërkohet duke kaluar ato prova historike, historia në tërësinë e saj është përtej betejave dhe luftërave që ne kemi lexuar. Historia është histori, sepse është përgjegjëse për ndryshimin e bazave më të rëndësishme të jetesës së njerëzimit. A ka disiplina e historisë ndonjë konventë në përcaktimin e dallimit midis "ngjarjeve aktuale" dhe "historisë"? Si e përcaktojmë historianët profesionistë rëndësinë kur një ngjarje ka kaluar dhe si e ndajmë qasjen nga politika dhe historia? A është kjo një çështje që historianët i drejtohen rast pas rasti, apo takojmë mendime të ndryshme tek mendimtarë të ndryshëm? Në vlerësimin tim historia është dija dhe realiteti që nuk diskutohet në mënyrë përmblylëse nga politika aktuale. Si thoshte Lukiani, "Historia nuk shkruhet që t'u pëlqejë atyre që janë në pushtet por që të jetë e besueshme për brezat që do të vijnë." Historia si shkencë gjithmonë merr një fushëpamje të →

re dhe rrok pikëpamje të reja, por gjithnjë në kuptimin e historisë dhe jo të politikës. A ka një përkufizim të qartë dhe profesional për atë se çfarë është historia dhe çfarë është politika? Dhe ndoshta edhe një pyetje shtesë: Çfarë e bën një ngjarje politike të bëhet edhe një ngjarje historike dhe anasjelltas? Kur përdorim metoda dhe burime historike ne bëjmë histori. Kur përdorim ndikimin dhe qeverisjen, ne bëjmë politikë. Dallimi në mes të historisë dhe politikës nuk është në ngjarjet, është në marrëdhënien tonë me ngjarjen dhe përdorimin e saj, në cilin këndvështrim ne përpigëni që ta vendosim ngjarjen. Si edhe thuhet: "Historia është një gjë e uritur, objekt i saj është studimi i së kaluarës. Një përkufizim shumë i gjerë ky. Por ekzistojnë probleme të përgjithshme që prekin të gjitha studimet historike dhe një sërë problemesh specifike për çdo periudhë kohore (me shtrirje rajonale dhe më gjerë) të studiuar. Mungesa e burimeve për historinë na vënë në vështirësi serioze, veçse një boshllëk i tillë nuk mund të mbushet me konsiderata politike. Qasjet dhe metodologjitë e politikës dhe historisë janë të ndryshme. Do të thosha se politika është e shqetësuar me atë se çfarë do të ndodhë më pas. Historia preokupohet me atë që ndodhi me të vërtetë. Normalisht në gjykimet shumëplansore ngjarjet nuk ndahen me thikë në historike apo politike. E njëjta ngjarje mund të shihet nga të dyja këndvështrimet. Historia tek çdo ngjarje afrohet me një mendim historik - duke përdorur mjetet e kërkimit historik. Një shkencëtar politik ose komentator politik mund të afrohet tek të njëjtat ngjarje por duke i këndvështruar si ngjarje politike. Dallimi nuk është në vet ngjarjen. Prandaj, nuk mendoj se mund të vendoset ndonjë kufij ndërprerjeje për të përcaktuar nëse ajo që ka ndodhur është një ngjarje thjesht historike apo jo. Edhe një ngjarje aktuale që ka pak kohë që ka ndodhur - si, p.sh., Rusia aneksoi Krimenë - është një ngjarje historike. Gjykimi i mirë për këtë do të përfshinte një komentim politik për të dhënë një shpjegim politik për atë që po ndodh, por gjithashtu, një histori-anë do duhej të përfshijë për të dhënë si rrënjët ashtu dhe perspektivën historike të saj. Ngjarjet nuk ndodhin në një vakum, gjithmonë ka një kontekst historik. Varet nga mënyra se si ne e interpretojmë atë. Studiuuesi i sociologjisë historike James Loewen në librin e tij "Gënjeshtrat që Mësuesi im më tha", bën dallimin midis asaj që ai e quan historia "sasha" (historia që ende kujtohet nga njerëzit që janë gjallë) dhe historia "zamani" (historia e cila tani është në thelb, e vdekur dhe akademike.) Bazuar në arsyetimin e mësipërm kemi të drejtë të pohojmë se nuk ekziston asnjë vijë e vërtetë ndarëse mes dy subjekteve, edhe pse ato mbulojnë gjëra të ndryshme, historia bëhet e politizuar gjatë gjithë kohës, por po kështu edhe politika mëson nga historia dhe përshtatet me mësimet e historisë.

Roli figurave historike...
Figurat historike janë njerëz të famshëm në histori që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e progresit njerëzor. Filozofët gjatë shekujve të kaluar kanë debatuar mbi rolet e figurave historike dhe ndikimin e tyre në historinë e qytetërimit si dhe përparimit njerëzor. Ndërsa

filozofi skocez, Thomas Carlyle, mendonte se studimi i figurave legjendare është një çelës për të kuptuar historinë, filozofi anglez Herbert Spencer ishte i besimit se individët historikë ishin të një rëndësie më të vogël. Pavarësisht nga debatet filozofike mbi këtë temë, nuk mund të mohohet se studimi për burrat dhe gratë e famshme në historinë botërore është vërtet një përvojë e pasur. Le ta shohim rolin e tyre në aspektin kulturor. Përcaktuar në mënyrë të zbutur, kultura i referohet vlerave të përbashkëta, besimeve dhe normave të një grupi të caktuar njerëzish. Platoni thoshte, "Kultura është realiteti". Kultura, pra, ndikon në mënyrën e të mësuarit, se si të jetojmë dhe se si të sillemi. Për këtë

Teoria e tij e quajtur Relativizmi Kulturor jep një kuptim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve themelore midis kulturës dhe personalitetit. Personalitetet e mëdha dalin nga kultura, të vegjlit nga mungesa e saj. Ismail Qemali i takon të parëve. Pa dashur të jem shterues; është rasti të risjell në vëmendje disa nga ato tipare që e përqasin Ismail Qemalin me figurat e mëdha të historisë së civilizimit borgjez. Kompromisi për të ishte i mundur vetëm kur të gjitha alternativat e tjera qenë provuar dhe kishin dështuar. Si debatues, shpesh ai nuk u tejkalua nga askush, sepse zotëronte aftësinë për ta shndërruar një demonstrim armiqësor në një vlerësim pozitiv ngazëllënjës nga kundërshtari.

tueshëm në mes të një korrupsioni të përhapur. Në të njëjtën kohë, ai u përpoq të vendoste autoritetin e tij mbi mendjet e njerëzve dhe për të arritur këtë ai ishte gati, nëse ishte e nevojshme, të kalonte mbi trupat e vdekur të kundërshtarëve të tij."

Kuptimi mbi rëndësinë në Histori... Cila është domethënia historike?

Domethënia historike është procesi i përdorur për të vlerësuar se çfarë ishte e rëndësishme për ngjarjet, njerëzit dhe zhvillimet e zgjedhura në të kaluarën. Historianët përdorin grupe të ndryshme kriteresh për t'i ndihmuar ata të bëjnë gjykime. Rëndësia është quajtur koncept i harruar në histori, pa dyshim, sepse mund të jetë sfi-

i pyetjeve rreth përkujtimin të këtyre ngjarjeve është e rëndësishme për të ndihmuar në zhvillimin e realizimit të botëkuptimit të brezive të reja që ka të bëjë në lidhjet me të kaluarën dhe të tashmes. Ekzistojnë një numër kriteresh që përdorin historianët dhe që mund të aplikohen për të përcaktuar rëndësinë e ngjarjeve.

" Rëndësia e ngjarjes për njerëzit që jetonin në atë kohë
" Rezonimi ndaj përvojës, bindjeve apo situatave të njerëzve që jetonin në atë kohë

" Rëndësia për një kuptim më të thellë të ditëve të sotme

" Si është vërejtur ngjarja nga njerëzit në atë kohë dhe që nga ajo kohë në ditët tona

" Si kujtohet ngjarja brenda kujtesës kolektive të një grupi

" Zbulimi i disa aspekteve të tjera të së kaluarës

" Rezultatet që patën pasojat për të ardhmen

" Qëndrueshmëria e ngjarjes që lidhet me faktin - për sa kohë janë prekur jetët e njerëzve prej asaj ngjarje. - Sa shumë jetë u prekën. Sa thellësisht u prekën jetët e njerëzve?

Studimi i Historisë është i rëndësishëm sepse na lejon të kuptojmë të kaluarën tonë, e cila na lejon të gjykojmë të tashmen tonë. Nëse duam të dimë se si dhe pse bota jonë është kështu, pra mënyra se si është ajo sot, duhet të shikojmë historinë për të gjetur përgjigje të sakta. Njerëzit shpesh thonë se "historia përsërit veten", por nëse studiojmë sukseset dhe dështimet e së kaluarës, ne mund të jemi në gjendje të mësojmë nga gabimet tona dhe të mos përsërisim ato në të ardhmen. Studimi i historisë mund të na japë njohuri për kulturat tona të origjinës, si dhe kulturat me të cilat mund të jemi më pak të njohur, duke rritur ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor në rrafsh kombëtar, rajonal dhe global. Studimi historisë na ndihmon në të ushtruarin për të fituar aftësi të të menduarit kritik dhe për përdorimin e tij jo vetëm në fushën akademike por edhe në fusha të tjera. Studimi i historisë na ndihmon për të kuptuar zhvillimet në vijimësi të botës së sotme. Studimi historisë ka shumë rëndësi se na mëson të mendojmë, na e pasuron eksperiencën me ngjarje dhe përfundime që vijnë nga një periudhë që ne nuk e kemi jetuar, pra historia në një farë kuptimi është më shumë se koha dhe vendi. Ajo na lejon të mendojmë për gjërat më të rëndësishme të njerëzimit duke filluar me pyetjen universale PSE? Historia e ndihmon njerëzimin të shikojë mbi refleksionin e saj. Ne duhet të shfrytëzojmë arsyetimet qofshin këto për gjëra të mira apo jo të mira, kjo varet nga eksperienca e fituar për t'u bërë më të fortë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë duke pasur më shumë shanse për mbijetesën dhe prosperitetin. Nëse nuk e studiojmë historinë nuk mund të kuptosh se kush është duke të udhëhequr keq në kohën që ti jeton. Njerëzit kanë gjithnjë një version të tyre për faktet ndaj ata që të mosqepërdoren kanë nevojë që të njohin dhe t'u referohen modeleve të provuara në histori. Është me rëndësi se sa më shumë të studiojmë sjelljen e njerëzimit në të kaluarën aq më shumë ushqehemi për rritjen intelektuale dhe zhvillimin individual. Studimi i ngjarjeve historike të së shkuarës na jep mundësinë të kuptojmë se si është koha do të jetojmë. Ndërtimi



shkak, shumë teoricienë besojnë se kultura është një farkëtuës i rëndësishëm i personalitetit tonë. Një nga supozimet e përgjithshme që pohan efektin e kulturës në personalitet është se: "Njerëzit që lindin dhe edukohen me kulturën e njëjtë kanë tipare të përbashkëta të personalitetit." Po të shikohet me vëmendje Cv-it e firmëtarëve të pavarësisht së Shqipërisë dallon kulturën e tyre, edukimin dhe formimin shumëplanësor, dijet dhe nivelin e tyre që përgjithësisht i përafraun në kuptimin e realiteteve dhe në rëndësinë e vendimmarrjes historike. Ngjarjet e mëdha epokale që i hapin udhë zhvillimit nuk mund të jenë punë dhe kontributi i njerëzve të pakulturuar. Personalitetet e kulturuar zgjidhin nyjet e vjetra historike dhe parasjellin të ardhmen. Një algjebër historike nuk mund të shtrijë dhe zgjidh ekuacionet e saja me mediokritet apo më keq akoma larg djesh dhe kulturës. Kjo është një nga sëmundjet që po vuajmë në dekadat e fundit si shoqëri dhe si institucionalizëm. Vijojmë që demokracinë institucionale ta trupëzojmë duke mbajtur në pushtet vendimmarrëse të paditurit. Rezultatet dihen dhe ndjehen, ecim në letra dhe kemi ngelur në realitet.

Sipas Franz Boas, pionier i antropologjisë psikologjike dhe i studimeve që lidhen me marrëdhëniet mes kulturës dhe personalitetit, personaliteti merret përmes kulturës dhe jo biologjisë.

Kur lexonte fjalimet e tij ai impononte heshtjen dhe vëmendjen. Ai guxonte të fliste edhe pa një dorëshkrim të përgatitur. Ismail Qemali si rrallë kush ishte lider i tillë që ndërtonte një kuptim të vërtetë të ngjarjeve dhe karakterizohet nga fuqia holistike, pra nga kapja e tyre si një e tërë, duke e shpënë arsyetimin në ndërkalljen dhe ndërvarjen e ngjarjeve të njëra-tjetra. Ai parashikoi aq sa mundi se çfarë ishte duke ardhur, shumë më mirë se nga disa prej bashkëkohësve të tij. Me gjithë inteligjencën e tij të zellshëm, ndershmërinë e tij të pastër ai nuk braktisi edhe përkrahjen dhe simpatinë për të varfërit. Ashtu si një burrë shteti i vërtetë Ismail Qemali ishte një politikan që shtrinte dorën, ishte i guximshëm dhe i thoshte gjërat hapur dhe me zë të lartë. Ai kurrë nuk u shfaq si një demagog në kuptimin e mirëfillt të fjalës. Ai ishte në thelb një njeri i kulturës. Ai ishte i sinqertë dhe në respekt të së vërtetës. I kujdeshëm për vuajtjet e njerëzve...Pakënaqësia krijonte te ai ndjenjë e shqetësimit. Ai spikaste sepse pasionet i shndërronte në urtësi dhe urtësinë në fuqi argumenti.

Do më pëlqente të citoj atë që thuhet nga francezët për Robespierin. Ndjeh një lloj përafërie jo ngjashmëriplotë me personalitetin e Ismail Qemali tonë të shtrënjët: "Fakt është se fanatizmi i tij, i cili rridhte nga pastërtia e qëllimeve të tij, e mbajti atë të pakorrup-

duese për të dy edhe për mësuesit edhe për studentët. "Mësuesit shpesh u tregojnë nxënësve se çfarë është e rëndësishme në vend që t'u kërkojnë të marrin në konsideratë atë që është e rëndësishme. Çelësi për të kuptuar rëndësinë është të kuptojmë dallimin midis mësimin të historisë së rëndësishme dhe t'u kërkojmë nxënësve të bëjnë gjykime rreth rëndësisë"; shprehet Matthew Bradshaw (Historia e mësimdhënies 2004) Kur mësojmë nxënësit apo studentët me rëndësinë historike të ngjarjeve, duhet të mbahet në vëmendje se vlera e disa ngjarjeve të kaluara mund të kontestohet nga breznitë e reja në situatën e tyre shkollërore. Duhet vlerësuar se çfarë mund të bëjnë ngjarjet dhe individët e identifikuar si më të rëndësishëm dhe cili është ndikimi që ata kanë në mënyrën se si ne jetojmë sot. Duhet kuptuar se rëndësia i atribuohet ngjarjeve dhe individëve në atë kohë, por edhe më pas. Çfarë rëndësie mund të ketë për fëmijët e sotëm, fjalave, studimi i temave për përkujtimin e ngjarjeve që ndodhën në Shqipëri 100 vjet më parë? A ka rëndësi nëse ata e dinë se cilat janë ngjarjet aktuale dhe kur dhe si ndodhën? Këto ngjarje kanë ndikuar të gjithë realitetin shqiptolës në të cilin fëmijët jetojnë sot, në lidhje me mënyrën se si u krijuan shteti në të cilin jetojnë, si ata qeverisen, ku është qeveria dhe lloji i shoqërisë më i mirë ku ata do të jetojnë. Ndërtimi

BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**



**MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**



**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID**

BalkanWeb.com
BW

FALAS



E DIEL

27 Janar

2019



Homazh për profesor Idriz Ajetin në përvjetorin e 102-të të lindjes

Kosovari që unifikoi gjuhën e shqiptarëve

NGA PROF. BARDHYL DEMIRAJ*

Profitur Idriz Ajeti mbush këtë vit plot 102 vite kur kundroi për të parën herë agun e mëngjesit në Medvegjë. Nuk i kanë mbetur më bashkëmoshatarë në këtë jetë, në mos sosh komilitonë shkollë a universiteti, që të kenë fiksuar në kujtesë datën kur i festonin ditëlindjet. Ndërkohë ish-studentë e ish-studentë të ish-studentëve të tij, të gjithë të zbardhur nga mos harreken e rropaten ende sot të qëmtojnë dëshmi bindëse, nëse ditëlindja e tij përkon zyrtarisht me ditën e sotme, shi më 27 janar 1917, apo do shtyrë me nja gjash të muaj, bash më 26. qershor 1917. Sigurisht që ky pseudo-problem, përpos dobisë së datimit të saktë biografik, së paku nuk i mballos kujt e

sidomos Fjalorit Enciklopedik Shqiptarë ndonjë të keqe shtesë, madje as që vjen e përgaset dot me atë zezonë të madhe kulturore-intelektuale për mbarë kombin shqiptar që nxisin dhe pleksin nata me natë Emilët tanë të periudhës së tranzicionit. Janë bash këta Emilë që nuk u bënë syri tërë e mëngojnë të dhunojnë deri edhe emrin e profesor Ajetit, duke e bërë bashkëautor pamfletesh gazetareske, thjesht e vetëm me ephsin për të minuar në çdo hap e me çdo kusht

nismën fan mirë të Këshillit Ndër akademik Shqipëri-Kosovë lidhur me mbarështimin në vazhdimësi të normës gjuhësore në shkrimin e shqipes, të cilën jemi mësuar ta lëçisim në kohën tonë më fort si Shqipja Standarde (me -d- në rrokjen fundore), duke u përgatitur "Rregullave të drejtshkrimit të shqipes" dimërimin e përjetshëm në ndonjë pavion të Muzeut Kombëtar, ja ashtu si çdo relike materiale-shpirtërore e trashëgimisë së vyer kulturore të popullit shqiptar.

Asgjëmangut, në përvjetorë të kësaj natyre çdo kumtues është i detyruar t'i anashkalojë këtij bërëllogu intelektual po-shqiptar në jetën e përditshme, duke u përçuar kështu thjesht dhe vetëm në thurjen e *laudatio*-sndaq Jubilarit dhe prurjeve të tij në kulturën mbarëshqiptare. Veçse në rastin tonë ky detyrim fatlum nuk e lehtëson asesi sendërtimin në letër të bardhë të dëshirës së madhe. Dhe arsyeja është e thjeshtë, thajse triviale: Jubilarin ynë ka mbushur ndërko-

hë një moshë biblike dhe penda e tij nuk ka reshtur së shkruari dekada me radhë. Por jo vetëm kaq: profesor Ajetin e kemi sot e gjithë ditën mes nesh e se kush ushqen dhe ushqehet me shpresën dhe dëshirën e mirë me përjetuar në vazhdimësi - qoftë edhe në formën e kumtit gojor e të bashkëbisedimit - përsiatjet e tij për çështje nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me shqipen.

→ Vijnë në faqen 14

Në këtë numër: TADEUSH RUZEVIÇ, PROF. BARDHYL DEMIRAJ, SUL GRAGJEVI DHE PAULIN SHESTANI, FARUK MYRTAJ, ARBEN ILJAZAJ

Profesor Idriz Ajeti, në përvjetorin e 102-të të lindjes, vjen me një shkrim të ndërjerë përkujtimor prej Bardhyl Demirajt

Ajo që profesor Idriz Ajeti bëri për gjuhën shqipe

In memoriam në përvjetorin e 102-të të lindjes

NGA PROF. BARDHYL DEMIRAJ*

Profesor Idriz Ajeti mbush këtë vit plot 102 mote kur kundroi për të parën herë agun e mëngjesit në Medvegjë. Nuk i kanë mbetur më bashkëmoshatarë në këtë jetë, në mos sosh komilitonë shkollë a universiteti, që të kenë fiksuar në kujtesë datën kur i festonin ditëlindjet. Ndërkohë ish-studentë e ish-studentë të ish-studentëve të tij, të gjithë të zbardhur nga mos harreken e rropaten ende sot të qëmtojnë dëshmi bindëse, nëse ditëlindja e tij përkon zyrtarisht me ditën e sotme, shi më 27 janar 1917, apo do shtyrë me një gjashtë muaj, bash më 26 qershor 1917. Sigurisht që ky pseudo problem, përpas dobisë së datimit të saktë biografik, së paku nuk i mballos kujt e sidomos Fjalorit Enciklopedik Shqiptar ndonjë të keqe shtesë, madje as që vjen e përqaset dot me atë zëronë të madhe kulturore-intelektuale për mbarë kombin shqiptar që nxisin dhe pleksin nata me natë Emilët tanë të periudhës së tranzicionit. Janë bash këta Emilët që nuk u bën syri tërë e mëngojnë të dhunojnë deri edhe emrin e profesor Ajetit, duke e bërë bashkëautor pamfletesh gazetareske, thjesht e vetëm me epushin për të minuar në çdo hap e me çdo kusht nismën fan mirë të Këshillit Ndër akademik Shqipëri-Kosovë lidhur me mbarëshkrimin në vazhdimësi të normës gjuhësore në shkrimin e shqipes, të cilën jemi mësuar ta lëcisim në kohën tonë më fort si Shqipja Standarde (me -d- në rrokjen fundore), duke u përgatitur "Rregullave të drejtshkrimit të shqipes" dimërimin e përjetshëm në ndonjë pavion të Muzeut Kombëtar, ja ashtu si çdo relike materiale-shpirtërore e trashëgimësi së vyer kulturore të popullit shqiptar.

Asgjëmangut, në përvjetorë të kësaj natyre çdo kumtues është i detyruar t'i anashkalojë këtij bërllogu intelektual po-shqiptar në jetën e përditshme, duke u përqendruar kështu thjesht dhe vetëm në thurjen e laudatio-s ndaj Jubilarit dhe prurjeve të tij në kulturën mbarëshqiptare. Veçse në rastin tonë ky detyrim fatlum nuk e lehtëson assesi sendërtimin në letër të bardhë të dëshirës së madhe. Dhe arsyeja është e thjeshtë, thuasje triviale: Jubilarit ynë ka mbushur ndërkohë një moshë biblike dhe penda e tij nuk ka reshtur së shkruari dekada me radhë. Por jo vetëm kaq: profesor Ajetin e kemi sot e gjithë ditën mes nesh e se kush ushqen dhe ushqehet me shpresën dhe dëshirën e mirë me përgjetuar në vazhdimësi - qoftë edhe në formën e kumtit gojor e të bashkëbisedimit - përsiatjet e tij për çështje nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me shqipen.

Një opsion i dytë për mua si shkruer i këtyre radhëve do të ishte në fakt edhe të përmbledhja kujtimet e tim eti, Shaban Demirajt për profesor Ajetin, por edhe kjo

Si e njoha profesor Idriz Ajetin

Unë i kisha a s'i kisha aty të 14-at atëherë, kur u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit në Tiranë (1972), dhe im atë ishte për mua si gjithnjë i vetmi person kontakti me botën, thënë më saktë qjellin e largët e të paarrishëm të Kosovës. Se kush ishte profesor Ajeti e çfarë rëndësie jetike kishte për ne kjo Shoqja Gjuhë me katër mbiemra: <Letrare Kombëtare e Njësuar Shqipe>, në fakt nuk arrija ta përtpija dot, por meqë i besojta tim eti në çdo fjalë që thosh, fillova ta dua edhe unë si i marrë profesorin tonë të nderuar, anipse nuk e kisha parë kurrë herë, as në fotografi.

temë nuk ezarohet dot brenda hapësirës që i mundëson "Milosao" një shkrimi sado të spikatur. Të dy i ka lidhur një kolegjalitet dhe miqësi e singërtë dhe e lashtë, andaj nuk është aspak çudi, përse emri i profesor Ajetit lakohej aq shpesh në famil-



jen tonë, qysh në fillimet e viteve 70-të të shekullit të shkuar, kur im atë filloi të vizitonte rregullisht Kosovën e unë si adoleshent mezi e prisja të kthehej me ndonjë top basketbolli apo me çimçakiz akaramelle e më pas, kur u "burrërova" - d.m.th. aty nga moshë 14 vjeç - edhe me cigare "Kent", që ia vidhja tinëz nga cantat.

Por le të kthehem në temë: Vësh-tirësitë që kisha në përzgjedhjen e njërit apo tjetrit opson më detyrojnë tash të ndalem thukët në dy dhunti të karakterit human dhe profesional të profesor Ajetit, të cilat i kam fiksuar dikur qysh fëmijë prej kumte vetë tim eti, ndërsa sot më mbetet vetëm t'i përditësoj drejtpërdrejt ose tërthorazi qoftë me aktivitetin e tij shkencor, ashtu edhe me angazhimin e tij social në mbarëshkrimin largvajtës të albanologjisë e të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Ndër këto dy dhunti, e para nuk është aspak e vështirë sot për t'u diktuar, e për këtë mjafton të shfletojmë me lexim diagonal prurjet e derisotme të profesor Ajetit, të përmbledhura qoftë edhe pjesërisht në opusin e tij pesë vëllimësh si botim i veçantë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (Prishtinë 1997/8). Ky opus, sikurse shumë e shumë botime të tjera, të organizuara këso rastesh jubilarë dëshmojnë qartë që në personin e profesor Ajetit gjëllin si dhunti e lindur etja për njohje të gjithanshme të shqipes. Rinia, shkolla, studimet

universitare, sikurse e gjithë jeta e tij shkencore-akademike konfigurojnë së bashku atë slljellje thuasje instinktive në aktivitetin e tij intelektual që feks e tingëllon sot në sytë e veshët tanë pikërisht si etje e amshuar për njohje të thelluar të shqipes në të gjitha perspektivat e mundshme, ndër to:

- shqipja si gjuhë e gjallë e me larmi varietetesh bashkëkohore (të folmet e Zaris dhe të Istriës, të Krajës dhe të Shëstanit, të zonësë Preshevës etj.);
- shqipja në fazat e ndryshme të evolucionit të saj historik;
- shqipja në marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinjë;
- kultura e shkrimit shqip në kohë e hapësirë (: shqipja e Kosovës në shek. XVI-II-XIX etj.); e last but not least;
- shqipja bashkëkohore në fokusin e planifikimit gjuhësor përgjithë hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan dhe diasporë.

Mjaftojnë këto prurje në gjithë këto fushame përsiatuar mirëfilliatëndërlidhni përmasash të pazakonshme me gjuhën shqipe që përjeton profesor Ajeti edhe në këtë qind-vjeçar të dytë të jetës së tij. Nuk gabojmë aspak, po të mëtojme tash se Shqipja, e personifikuar në Zonjën Shqipe, është pas gjase Ora e tij personale, që i rri gjithëherë pranë, e shoqëron, e mbrondhe e orienton në jetën e tij intelektuale. Kështu i përcillja dikur si adoleshent fjalët e tim eti, që gjithmonë ngazëllehej, kur binte fjala për profesor Ajetin me Çetën e tij të Profetëve Gjuhëtarë të Kosovës, e thosh: "Or" po, ata do na lënë prapa shpejt neve këtej. Jo për gjë, por...; se

Shkrimtarja australiane Geraldine Brooks nderohet me çmimin “Ramiz Kelmendi”

C
MMMI

Festivali i Letërsisë në Orllan (FLO) ka kënaqësinë të njoftojë se laureat i çmimit Ramiz Kelmendi këtë vit është autorja me origjinë australiane, Geraldine Brooks.

Brooks nderohet me këtë çmim për rikonstruktimin mjeshtër të një historie të vërtetë, histori mahnitëse dhe jashtëzakonisht të fuqishme, The Book of Exodus (Libri i ekzodit). Kjo kronikë, e botuar në revistën The New Yorker, mbulon një periudhë që shtrihet nga okupimi gjerman i Sarajevës në Luftën e Dytë Botërore deri në Luftën e Kosovës më 1999, kur ndodhi eksodi masiv i kosovarëve, pikërisht njëzet vjet më parë. Artikulli ishte rezultat i hulumtimit që

autorja bëri për romanin e saj People of the Book, i cili u frymëzua nga rrugëtimi i Librit të Ekzodit që njihet si Haggadah e Sarajevës.

Në një korrespondencë para publikimit të njoftimit, Brooks tha se ndihet e nderuar me çmimin.

Geraldine Brooks është autore dhe gazetare që u rrit në periferinë perëndimore të Sidnejt. Punoi si reportere për The Sydney Morning Herald para se të fillonte punën për The Wall Street Journal, ku mbuloi krizat në Lindjen e Mesme, Afrikë dhe në Ballkan.

Në vitin 2006 u nderua me çmimin Pulitzer për letërsi për romanin March. Romanet e saj, Caleb's Crossing dhe People of the Book, ishin bestseller të New York Times-it. Romani i saj i parë, Year of Wonders është bestseller ndërkombëtar, i përkthyer në më shumë se 25 gjuhë dhe i përzgjedhur për



t'u bërë film me Andrew Lincoln në rolin kryesor. Ajo është autore edhe e veprave dokumentare Nine Parts of Desire, Foreign Correspondence dhe The Idea of Home.

Çmimi Ramiz Kelmendi u themelua më 2013 për të nderuar njërin prej shkrimtarëve më të mirë dhe më popullor të Kosovës, gazetar veteran dhe përkthyes i mirënjohur. Me çmimin Ramiz Kelmendi në të kaluarën janë nderuar Peter Constantine, përkthyes me renome botërore, Faruk Šehiç, shkrimtar nga Bosnja që konsiderohet një prej autorëve më të mirë të generatës së tij në Ballkan. Laureatë të çmimit janë edhe Sanije Gashi, për kontributin pesëdhjetëvjeçar gazetarisë dhe publicistikës në Kosovë, Sokrat Shyti nga Shqipëria, si mirënjohje mbijetesës së njeriut dhe letërsisë, dhe Luan Starova, nga Maqedonia, për njohje më të gjërë të letërsisë shqipe në botë.

jo vetëm i kanë mundësitë, xhanëm (!), për literaturë..., por sikur..., ata sikur kanë lindur për gjuhëtarë." E unë si fëmijë fantazoja, se si profesor Ajeti, kur kishte lindur dikur aty nga viti i largët 1917, kishte pranë si vejtore të fatit Orën Shqipe. Ora Shqipe i kishte diktuar orientimin në jetë, deri si të ecë e të vallëzojë virtualisht me të, kur dhe si të kombinon hapat para e mbrapa e kur të kthejë djathtas, apo të rrotullojë majtas.

Pikërisht në këtë qerthull marrëdhënies virtuale me Orën Shqipe diktojmë edhe atë dhunti të dytë, në personin e profesor Ajetit. Ani, është kjo një dhunti, pas gjase po e lindur, por që arrijmë ta deduktojmë mirëfilli si të tillë, sidomos kur përqendrohemi në angazhimin e tij social, bash kur ngjetojmë ashtu mes rreshtash në shkrimet, qëndrimet dhe intervistat e tij ndaj planifikimit gjuhësor, përkatesisht njësimi të normës gjuhësore për shqipen e shkruar në gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan.

Lejojmë të kujtojmë në këtë rast thjesht përvojën tme personale, pikërisht mënyrën se si e kam përjetuar - ndonëse me shumë vonesë (!) - atë angazhim social të profesor Ajetit në shkrimet e tij për gjatë rrjedhës së procesit të normzimit të variantit të shkruar të Zonjës Shqipe. S'kam përsë e fshih atë mbresë të thellë që më ka lënë njëri ndër artikujt e hershëm, në mos më i hershmi i botuar i profesor Ajetit në këtë fushë: "A ka gjë më punë ortografinë e shqipes?" (Përparimi, Prishtinë 1958, nr.7-8, f.471-476). E përçjellim rishitas këtë shkrim në opusin pesëvëllimësh të profesor Ajetit, duke e shoqëruar njëherësh me buzëqeshje të rastit si edhe me seriozitetin e duhur: a) me buzëqeshje të rastit, sa i përket formës aktuale, meqë shkrimi original është përshtatur i tëri në variantin normativ letrar të Zonjës Shqipe, madje qysh në titull: "A ka më punë në ortografinë e shqipes" ("Vepra", bl. 2, f. 203-7); sikurse b) me seriozitetin e duhur, sa i përket mesazhit të natyrës universale që emeton ky titull, sidomos në kohën tonë dhe në hapësirën tonë shqipfolëse, bash kur ish-nxënësi të tij e shtrajnë sot rishitas këtë pyetje si imperativ i kohës.

Prashtu pa dashur të zgjatim, lejojmë të shtoj pa drojë, se ngjërimi i këtij shkrimi të parë sikurse i qdo shkrimi, qëndrimi e interviste të mëvonshme që ka botuar e dhënë profesor Ajeti këta 6 dhjetëvjeçarë në vazhdim për çështje të normës gjuhësore, mësjellë ndërmend kumtin e dikurshëm ngazhlyes të tim eti, të cilin ma përsërishte shpesh: "Që sot kemi një shqipe të njëjësuar, mor bir (!), këtë duhet t'ia dimë [për nder] Kosovës, e cila u sakrifikuara përsëri për ne". sakrifica e parë shoqëroi cungimin e dikurshëm të Shqipërisë - dhe i shkëlqenin gjithnjë sytë kur përmendte

me këtë rast emrin e profesor Ajetit.

Unë i kisha a s'i kisha aty të 14-at atëherë, kur u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit në Tiranë (1972), dhe im atë ishte për mua si gjithnjë i vetmi person kontakti me botën, thënë më saktë qiellin e largët e të paarrishëm të Kosovës. Se kush ishte profesor Ajeti e çfarë rëndësie jetike kishte për ne kjo Shoqja Gjuhë me katër mbiemra: <Letrare Kombëtare e Njësuar Shqipe>, në fakt nuk arrija ta përtpyja dot, por meqë i besoja tim eti në çdo fjalë që thosh, fillova ta dua edhe unë si i marrë profesorin tonë të nderuar, anipse nuk e kisha parë kurrë herë, as në fotografi. Ja që kjo rrethanë më ndihmoi shumë, se fillova ta përfytyroja profesor Ajetin tamam si Prometheun mitik, duke i sjellëzjarrin, që vjen me thënë gjuhën letrare-kombëtare të njësuarshtqipe vëllëzërve tanë në Kosovë, e ashtu me bark të çjerrë e me mushkëri të përgjakuragjimento sa tundej dheu: "S'ka më Shqypni, as Dhe t' Arbnit, asmãGegni, ka vetëm Shqipëri, Arbëri e Gegëri!" Më vonë, filloi të më vinte vërtet shumë keq ta shihja profesor Ajetin ashtu të shqyer e të sakatosur, si mos o Zot! Prandaj ndërrova mendje shpejt dhe e këmbëva Prometheun me Odinin, babazotin e mitologjisë nordike. Edhe ky zot babaxhan ishte, e po aq i etur për dije, meçurie sakrifika si profesor Ajeti; andajla pengfillimisht një sy, vetëm e vetëm që të pinte një kupë prej Burimit të Dijes që e ruanë ZonjaMirmir, ndërsamëvonë, kur donte të mësonte edhe zanafilën e shkrimit runik, nuk e bëri më të gjatë, por u vetëvar për nëntë ditë e nëntë net me radhë në Pemën e nëntë Botëve (Yggdrasil). Ja që pas nëntë ditëve së nendenjuri varur e mësoi edhemisterin e gjuhës Runa e sipas mitologjisë nordike jet e gjëllin sot e gjithë ditën shëndoshë e mirë në qiellin e nëntë.

Për fatin tonë të madh, edhe profesor Ajeti, jo vetëm që e njeh dhe zotëron shqipen letrare, ase Standardin - siç po mësohemi ta mësojmë përmendësh këtë fjalë sot - por gëzon edhe shëndet të plotë, duke përjetuar me këmbë në tokë e mes nesh përvjetorët e tij biblikë. Veçse nuk është thjesht dhe vetëm etja për dije ajo dhunti e lindur që e nxitit profesor Ajetin të sakrifikohej për Runa-n shqipe. Vijnë kështu tek ajo dhunti e dytë, e lindur ashtu natyrshëm te shqiptari i thjeshtë i Medvegjës, i Kosovës dhe i Shqipërisë mbarë: dëshira me qenë gjithmonë bashkë, bash sipas motos "një komb - një gjuhë".

* (LMU München/RFGJ)

R
REVIEW

“Magazina e komunizmit shqiptar”

NGA ARBEN ILJAZI

Shqipëria në 28 vjet tranzicion po kërkon vetëveten. Por ne nuk mund të integrohemi pa njohur veten, ashtu siç kemi dhe siç kemi qenë para ndryshimit të sistemit. Nuk mund ta përgëneshetrojmë kursesi kulturën materiale dhe shpirtërore të sistemit të kaluar. Kjo nuk ka lidhje me mbylljen e plagëve të atij sistemi.

Duke njohur atë kulturë ne do mund të kuptojmë veten ku kemi qenë dhe ku duhet të shkojmë. Siç thotë Umberto Eco “Civilizimet nuk mbijetojnë dot pa kujtesën kolektive. Kur ndonjë akt censure përpiqet të zhdukë një pjesë të kujtesës së një shoqërie, kjo shoqëri pëson krizë identiteti. Në një botë në të cilën tentohet të harrohet apo të injorohet shumë, rizbulimi i së shkuarës sonë kolektive duhet të jetë projekti themelor i së ardhmes”.

Edhe në komunizëm ne ishim bartës të një trashëgimie atipike, pasi edhe vetë komunizmi shqiptar ishte atipik. Shteti shpesh herë u karakterizua nga shpërfillja e përgjegjësisë njerëzore dhe izolimi teknologjik. Por kishte shumë njerëz që i kuptuan nevojat shpirtërore të popullit dhe improvizuan sende dhe vegla utilitare nga më të çuditshmet. Albumi “Magazina e komunizmit shqiptar” i autores Elektra Çapaliku, vepër që sapo ka dalë nga shtypi, përbën një kontribut me vlera në lëmin e kulturës sonë materiale e shpirtërore. Në këtë album janë përzgjedhur rreth 500 imazhe objektsh që kanë shoqëruar jetën e njeriut shqiptar në periudhën e sundimit komunist: Triska e

Albumi “Magazina e komunizmit shqiptar” i autores Elektra Haxhia Çapaliku, vepër që sapo ka dalë nga shtypi, përbën një kontribut me vlera në lëmin e kulturës sonë materiale e shpirtërore...



tollona, mobilje, elektro-shtëpiake, pajisje për ngrohje dhe gatim, ndriçues, telefona, aparate fotografike dhe orë, enë kuzhine, kafe e takëme kafeje, cigare dhe takëme duhani, ujë dhe lëngje të tjera, ushqime, pije alkooolike, veshje dhe mbulesa, lavanteri, lojëra, artikuj shkollorë, pajisje zyre, biçikleta e motocikleta, lekë, si dhe objekte të tjera të ndryshme. Në këtë libër përvç objektve të paraqitura gjenden edhe një numër aktesh të botuara në gazetën zyrtare, foto private si dhe faksimile dokumentesh që autorja i ka gjykuar si më të rëndësishme.

Mbi ngrehinat e jetra të kulturës materiale e shpirtërore janë hedhur tashmë shumë kate të reja dhe progresive në frymën e zhvillimeve të reja evropiane e botërore, vërehet një lulëzim i ri i energjive kombëtare, por pavarësisht nga ky lloj ekzaltimi, pavarësisht nga ecuria apo krizat e sistemit të ekonomisë së tregut dhe zhvillimeve demokratike, botime të tilla në fushën e kulturës materiale dhe dezintoksikimi i librave të historisë janë nga nevojat më parësore.

Absurditeti i sakrificave për të mbijetuar në periudhën komuniste padyshim që i nxit brezat e rinj për një vizion më optimist dhe më konstruktiv në të ardhmen.



P

POEZIA

Kjo përmbledhje poezish vjen nga një prej autorëve më të spikatur të Lindjes dhe që ka bërë historinë e poezisë jo thjesht në Poloni, por në të gjithë gjysmën e dytë të shekullit të shkuar me figurat dhe idetë e tij të pasura, shprehur në një poezi tepër të ndjerë. I gjithë vëllimi me poezitë e tij vjen falë "Poeteka" dhe Ambasada polake në Tiranë...

NGA TADEUSH RUZEVIÇ*

I mbijetuar

Jam njëzetë-e-katër vjeç
i përcjellë në kasaphanë
mbijetova.

Të tjerat sinonime të zbrazëta:
genia dhe shtaza
dashuri urrejtje
miq e armiq
terr dhe dritë.

Njësoj writen genie dhe shtazë
e pashë vetë:
Ngarkesa njerëzish të sakatuar
më nuk shpëtohen.

Idetë janë thjesht fjalë:
virtuti dhe krimi
e vërteta gënjeshtër
bukuria shëmnia
kuraja dhe frika.

Virtuti dhe krimi peshojnë po një-
soj
e pashë vetë
tek një njeri që ishte poaq
kriminel sa dhe i virtytshëm.

Kërkoj një mësues dhe një mjesh-
tër
të mund të m'kthente t'parën,
dëgjimin dhe fjalën
të mund t'u jap sërish emër objek-
teve e ideve
të mund ta ndaj errësirën prej drite.

Jam njëzetë-e-katër vjeç
i përcjellë në kasaphanën
mbijetova.

Shikoj të marrët

Shikoj të marrët
që ecnin mbi det
besonin deri në fund
por arritën fundin

ata ende lëkundin
varkën time t' trazuar

ato duar të ngurta
egërsisht i largoj

i shtyj tutje ato vit pa viti

Gështenja

Më e trishta prej të gjithave
ikja nga shtëpia një mëngjezi
vjeshtë
kur s'ka më shpresë për kthim
t'shpejtë


Gështenja që babai mbollti ballë
shtëpisë
na u rrit para syve

nëna aq e vockël
sa mund ta mbaje ndër duar

Mbi rafte

poçe plot me zahire
mu njësoj si zotat gojëmblla
kanë ruajtur kurmin
e rinisë së përrjetshme

ushtarët në fund të sirtarit
do t'qëndrojnë aty gatitu deri në



fund të botës

kurse Zoti i plotfuqishëm që përz-
ien
hidhësinë me ëmbëlsinë
i pikturuar aq keq
rri i varur mbi mur i pa shpresë

Fëmijëria i ngjan imazhit të cjerre
mbi një monedhë ari që tringëllon
si e vërtetë.

Kthimi

Befas dritarja do t'hapet
nëna do thërrasë
erdh' koha për t'hyrë brenda

muri tani na ndan
hyj në parajsë me këpucë
t'baltosura

i qasem tryezës
duke iu përgjigjur pyetjeve kutu-
ru

po, jam mirë, thjesht më lini
t'get. Me kokën ndër duar
ulem e rri. Si mund t'ua tregoj
atë rrugë të gjatë
dhe aq të koklavitur

Këtu në parajsë nënat
thurrin shallë t'jeshiltë

mizat gumëzhijnë

babai dremtit ndanë sobës

pas gjashtë ditësh punë

Jo- sigurisht, s'mund t'iu them
që njerëzit kacafyten
me njëri-tjetrin.

Për cilindo që këqyr

Për cilindo që këqyr t'imë më
me robdeshambrin purpuri një spi-
tal të bardhë
drithëruar
shtangur
me buzëqeshjen e drunjte
dhe shapkat e bardha

e cila pesëdhjetë vjet besonte
ndërsa tani vajton dhe thotë
'nuk e di...nuk e di'

fytyra e saj si një njollë e stërmad-
he loti
me duart mbërthyer si
një vajzë e vogël e ndrojtur
buzët e saj shndërruar në mavi

cilindo që e sheh nënën time
at' kafshëz gjuajtëse të vogël
me sytë e mbufatur

ai

oh, sa do doja ta mbartja në zemër
dhe ta ushqeja atë me ëmbëlsi.

Çfarë fati

Çfarë fati t'i zgjedh

manaferrat në pyll
mendova se
s'ka më pyll dhe as manaferra

Çfarë fati të shtriqem
në hije të pemës
mendova se pemët
s'derdhin më hije

Çfarë fati që jam me ty
zemra më rreh kaq fort
dikur mendova se njeriu
s'ka më zemër.

Gërshet

Pasi të gjithë ngarkesës së grave
ia rruan kokat
katër t'ngarkuar me fshesa degë
mëshhteknash
pastrojnë
dhe mbledhin tok flokët

Pas xhamave të pastër
flokët e kufomave dergjen
sak të atyre mbytur në dhomat e
gazit
në këtë flokënjajë
plot gjilpëra me kokë dhe krehëra

Floku nuk goditet përmes dritës
as nuk lëviz dot prej puhisë
s'mund ta preki ndonjë dorë
as shiu apo buzët

Brenda gjokseve t'mëdha
resh flokëve të thatë
të atyre që u mbytën
qëndron një gërshet i venitur
veçuar me një fjonjo
tërhequr mbase dikur në shkollë
nga djemtë çapkën
Muzeumi i Auschwitz, 1948

Masakra e djemve

Fëmijët qanin "Mami!
por unë isha mirë!
Terr! Terr!"

I këqyr, Ata po treten në fund
Ua shoh këmbët e vogla
ata shkuan mu në fund. A i shiko-
ni
ato gjurmë
të këmbës së vogël aty-këtu

xhepat e fryrë
plot tela dhe guricka
dhe kuajt e vegjël prej telash

Afër, një fushë e madhe
mu si një figurë gjeometrike
rri pema e bërë prej tymit të zi
një pemë e vdekur
vertikale
pa asnjë yll mbi kuror t'vet.
Muzeumi i Auschwitz, 1948

Dielli i ri

Dëgjoj gërvishtjen
Është ajo zonja që cjer
mbi mur me thonjtë e saj të vegjël
duke u kollitur si një kafshëz e
vogël

Kështu unë shkoj te ajo
ulem në tavolinën e rrumbullakët
tekta ajo mbledh shpirtat
rreth një pjatëze dhe gjerb çaj
me glënjka të vogla zogjsh



Me ata zotërinjtë
me mjekra
'jenseits von Gut und Böse'
çereku i fundit i shekullit të 19-të

Ajo tund kokën e saj të vogël të
thatë
dhe flet për Venecian
Firencen dhe diellin italian

U linda baroneshë
Po ky është fundi i botës
tanimë na kanë shpikur diej dhe
yje të rinj
-thotë ajo-
dhe sakaq sytë i përloten.

Koka në zbrazëti

Nëse mendon se
je një kokë e bukur
e ngritur
mbi lartësi

nëse mendon se
je një kokë e zgjuar
e një trangu palëvizije
që zhyt në tokë
gjak dhe bajga

Nëse mendon se je qark
mbi orbitat e qashtra të intelektit
ku nga poshtë mund të dëgjosh
vetëm
turmën nxitëse të zhurmshme
dhe gjuhënxjerrëse

nëse e mendon këtë
ti je kokë
që tundet këndshëm
në ajrin e shpopulluar

ti je ajo kokë pra
e cila duhet hequr
dhe flakur tutje.

Përjetimi i fëmijërisë

Në mesin e ditës
ish i lumtur si zog
mes shpatave lëbyrëse të diellit
llangosur n'gjak

Një balonë e verdhë fekste
në vorbullën e tymtë
si sytë e një dragoi

Djali besonte se ishte zog
fugonte mes lëndinave gjelbëroshe

plot britma

Natën e ndoqa
prej frymëmarrjes së tij të shpesh-
të

Tavolina mbi të cilën pështeta
kokën
i ngjan trungut
të pemës të rrëzuar.

Dëshmitar

I dashur, ti e di se jam brenda
por mos u fut befaz
në dhomën time

ti mund të më shikosh
të heshtur
mbi një kartë të bardhë

Mund të shkruash
rreth dashurisë
po kur dëgjon të qarat
e të masakruarve dhe turpërimit
atëher' më shkruaj
rreth vdekjes
duke këqyruar fytyrat e pakta
të fëmijëve

Mos u fut pra befaz
në dhomën time

Ti do të shikosh një
dëshmitar të pagojë
dhe të mpakur të dashurisë
kaplaur sak prej vdekjes.

Një fshatare e vjetër ecën përgjatë plazhit

Ecën përgjatë plazhit
pëshqjellë shallit të bardhë të
pastër

valët zgjaten drejt saj
të reja dhe t'gëzueshme si livadh
përmes të cilave ajo ngutet
të shkojë

Fshatarja e vjetër ecën
përgjatë plazhit

është ende e lodhur
dhe e fërgëlluar
ende plot me rrëmujën
e udhëtimit
e dritave artificiale
gjesteve të tepruara



tymit mbi tryeza
të një nate mbytëse
brenda vagonit të mbyllur
thirrjeve të ftohta prej altoparlan-
tit
përgjatë peronëve vibrues

Mbërriti këtu në agim

Lule të panjohura dridhmojnë
mbi duna argjendi
në fiçe-barërat e mprehta
dhe dritat e rozta

Ecën
duke lënë gjurmë mbi rërë
E para
grua nga ai fshat gjendet në këm-
bët e kodrës
që po çapitet përgjatë rërës

vala e fshin krejt gjurmën
duke lënë
mbi rërë
një guaskë
me një të brendshme të ndritshme
të leshterikëve të detit
kërcejve të roitur
pikave të fikura
t'qelibarit

Ajo ecën
përgjatë plazhit
përkulet
mbledh një grusht ujë
e zhyt fytyrën e vet brenda
ndjen detin në buzë t'veta
si loti

*

Me shaminë e bardhë
lidhur nën mjekër
e këpucët që i varen mbi shpatull
-kjo është udhëza prej nga ku sh-
kon për tregun në qytet
të shpëtoj shuajt-
ecën pra njësoj

Kushedi sa vjet ka ecur kështu
përmes tokës dhe ujit
përmes dunave dhe breshrit
përmes shiut dhe shkëlqimit
guriçkave dhe barit
përmes reve dhe tokës
përmes portave me mburojë
përmes kishave të gurta

për gjysmë shekulli ka qenë duke
ecur

drejt detit të gjerë
përderisa rendi i ri
i punëtorëve dhe fshatarëve të rinj
e ka sjellë atë mu në breg

Deti i futet qiellit
brenda det-qiellit
një çafkë këlthet
një sorrë e bardhë deti
një djep të imët mbi kresht

Fshatarja e vjetër
ecën përgjatë plazhit
zgjedh një guaskë
dëgjon
qesh
me qiellin e detin
dhe me vetveten

Mu një e tillë guaskë i rri
mbi komodinë
mes luleve bërë prej lulesh
mes imazheve të shenjtoreve
dhe një topi të kristaltë
në të cilën bora e blunjtë
ndjen pafundësisht
popullin e vjetër duke thënë
deti është i përmblytur brenda
guaskës
dhe shkëlqimit të syve të fëmijëve

*

I riu që flakte dhe kapte pas
një top të kuqë përgjatë gjemimit
të valëve
pa një grua të vjetër
me shaminë e bardhë mbi kokë

Sytë e saj gjysmë të mbyllura
fytyra e saj
fekste në dritë
si lulja pas shiut

Deti i gjerë e rreftu
1952

Pema

Të lumtur ishin
poetët e dikurit
kur bota dukej si pemë
e ata si fëmijë

Çfarë duhet të var
mbi degën e një peme
e cila i ka vuajtur
shiut t'çeliktë

Të lumtur ishin ata
poetët e dikurit
tek vallëzonin rreth pemës
si t'ishin fëmijë

Çfarë duhet të var
mbi degën e një peme
e cila është djegur
dhe kurrë më s'do këndojë

Të lumtur ishin ata
poetët e dikurit
poshtë lisit
ata këndonin si t'ishin fëmijë

Kurse pema jonë
thjesht gërvin natën
me peshën
e një trupi të përbuzur

*Përktheu nga anglishtja
Ben Andoni

Opinion *i* Ditës

Shqiptarët si pushtues në Shqipëri dhe puthja sovjetike e armikut Nikita Hrushov

Nga Lorenc Vangjeli

(vijon nga faqja 1)

... në buzë Nikita Hrushovit. Shefi i Kremlinit erdhi e iku nga Tirana në maj-qershor të vitit 1959 duke shkelur jo mbi tapet të kuq, por mbi petale trëndafilash. As ai dhe as Hoxha nuk e dinin se vetëm një vit më pas, stina e dashurisë shqiptaro-slave dhe mëria mes palëve do t'i zëvendësonte me kaktus trëndafilat. Divorci ideologjik ishte arsyeja që, çfarë kishte thënë kryesovjetiku nëpër Shqipëri, të shihej me shumë armiqësi. Edhe këshillat për zhvillimin ekonomik të vendit, që Hrushovi i shpërnda si karamelle nëpër Shqipëri. Një nga to kishte të bënte me ftesën për të zhvilluar industrinë e lehtë dhe ushqimore në vend të asaj të rëndë dhe një tjetër ishte propozimi për të mbjellë agrume në vend të drithrave. "Sa grurë do Shqipëria në një vit, aq hanë minjtë në hambarët sovjetike", tha Hrushovi në vendin e shqiptonjave krenare.

Shqipëria e Hoxhës nuk bëri as njërin dhe as tjetrin, por rendi si pulë pa kokë drejt kokrrës së misrit. E izoluar për drejt nga njerëzia dhe e drejtuar nga marrëzia, veç të tjerave, dreqosi edhe çdo marëdhënie të njeriut me natyrën; në vend të limonave dhe portokalleve, kërkoi të prodhojë vetëm bukë dhe atë traktorin e kuq me zinxhirë, model i viteve 30-të, që nuk i hynte në punë as drejt që ecën nëpër gurë. Koston e izolimit tragjik e paguajmë ende sot kur jemi të lirë të lëvizim përtej kufirit, por rrimë brenda të njëjtës mendësi komuniste të zhvillimit të vendit. Pa pasur pothuaj asnjë ndryshim nga mentaliteti që paguan me miell për çdo lloj krundeje.

Një nga mitet më jetëgjatë për sukseset e komunizmit në Shqipëri kishte të bënte me bukën e përditshme. Garantimi i bukës në një vend të varfër si Shqipëria, konsiderohej si vetë kuptimi tërësor dhe synimi kryesor i jetës. Propaganda naziste e komunistëve të djeshëm për tharjen e kënetave



apo kthimin e kodrave dhe maleve në toka buke, sa për të marë një shembull, ishte kaq agresive sa mbijeton edhe sot në forma të tjera; duke zëvendësuar ankthin për bukën me makthin për paratë.

Nëse dje, në emër të bukës, justifikohesh çdo marrëzi kriminale në zhvillimin e vendit, sot në emër të babëzisë për para, çdo krim i marrë mjedisor tregtohet si politikë zhvillimi.

Tharja e kënetave të djeshme shkatërroi ekosisteme shekullore dhe zëvendësoi peshkun, ngjaltat dhe gjahun tjetër me grurë e misër.

Hapja e tokës së bukës në kodra e male i shpyllëzoi ato, prodhoi vetëm për dy-tre vjet patatën që komunistët e shisnin edhe si bukë, edhe si gjellë dhe më pas ju dorëzuan në mënyrë të pakthye-

shme erozionit. Duke krijuar peisazhet e trishtuara të maleve tona, si një kujtesë se budallëku njerëzor nuk ka fund.

Kapitalizmi kaotik dhe gjithashtu budalla shqiptar ka bërë të njëjtën gjë. Babëzia e lemerishme i është turrur çdo lumi, përroi, proske apo vije uji për të ndërtuar hidrocentrale me të njëjtin rezultat, shkatërrimin e ekosistemeve shekullore dhe duke dëmtuar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. E njëjta histori me kërkimet për naftë apo dhe me vetë ndërtimet makabre të bëra kudo nëpër bregdet.

Kërkojmë turizëm, por shkatërrojmë të vetmen ofertë turistike që mund t'i afrojmë turizmit: një cep toke e deti ende të papërkur. Mbjellim erë për të korur uragane dhe ujisim shi për të

vjelë breshër! Fatmirësisht Firenca është aty ku e ndërtuan matanë Adriatikut sepse sikur të kishte ardhur e gatshme kësaj ane të të njëjtin det, sot do të ishte ajo si Tirana dhe Arnoja si Lana. Por tashmë, nguti shqiptar për të prodhuar shkrepse për t'i vënë zjarrin çdo pylli, ka ardhur në momentin e moskthimit. Zagoria, Divjaka e Karavastaja, Valbona, kanionet e Holtës, Osunit, Vjosa e kudo tjetër nga jugu në veri të vendit, janë apeli që bëhet sot për të mos humbur nesër edhe atë çfarë ka mbetur. Edi Rama reagoi menjëherë e siç duhet edhe në rastin e Zagorisë, edhe në rastin e kanioneve të Holtës, mbas paralajmërimit të Taulant Ballës e deputetëve të tij të Elbasanit. Lipset që sot ai të bëjë diferencën me ata që janë ulur përpara tij në

karrigen që drejton vendin. Dhe të kuptojë se në një vend si Shqipëria, shpesh është më e rëndësishme jo ajo që bën mirë, por ajo që nuk lejon të bëhet keq!

Vendimmarrja politike duhet vendosë përfundimisht se cila është e nesërmja që do të projektojë për shqiptarët ende të palindur, që janë bashkaksionerë në çfarë Perëndia i fali këtjv vendi.

Shqipëria do të ekzistojë edhe mbasi të ikin e të harrohen gjithë ata që kanë qenë qeraxhinj të pushtetit në vend dhe e kanë trajtuar vendin me egërsinë e pushtuesve të dikurshëm. Por me siguri ata që do të vijnë, brezat e ardhshëm, do të thonë me trishtim për paraardhësit e tyre: pushtuesit të paktën iknin dikur, por marrëzia e shqiptarëve që u sollën me këtë vend si pushtues të egër, do të mbetet shenja e turpërimit për të gjithë!

Ka disa vargje ironike të hershëm që këndohen në shumë variante, por që në pak a shumë thonë: Morëm malet të lëftojmë/ për liri e për Atde/ ku ta dinja un' i mjeri/ që armiku ish' me ne! Sot kur makutëria, babëzia dhe padija konkurojnë me njëra - tjetrën se kush i jep puthjen e Judës Shqipërisë, ja vlen të kujtohet se puthja sovjetike e Hrushovit 60 vjet më parë për Hoxhën, në thelb nuk ishte thjesht një gjest dashurie mes burrash, por një dëshmi tronditëse se Nikita i stepave sllave, e kishte kuptuar këtë vend më mirë se pushtuesit e tij shqiptarë.

Javaneews

Opinion i Ditës

Marshi mbrapsht i timonierit

Nga Fatos Çoçoli

(vijen nga faqja 1)

... e tij i referohet shpesh shprehjes "Zmbrapsja si art i pathyeshmërisë", kur flet për drejtuesit e politikës reale në qytet-shtetet italiane të kohës. Timonieri ynë e provoi marshin mbrapsht dy muaj pasi mori pushtetin, në nëntor 2013, me protestat masive kundër sjelljes së armëve kimike nga Siria për asgjësim në territorin shqiptar. Me gjithë tortën e ofruar të përfitimeve politike dhe ekonomike nga aleati ynë i përherëshëm strategjik, SHBA-të, timonieri tha njëherë po, por diti të zmbrapsje, duke dëgjuar e mos injoruar zërin e qytetarëve. Kjo e shpëtoi Shqipërinë nga një përshkallëzim protestash, revoltash dhe pasigurie. Pesë vite më vonë, kur protestuan studentët, pranoi të kthehej në tabelë qitjeje kolektive pezmi, duke duruar shpërthimet dhe zbrazjet me mungesë flagrante të edukatës të shumë prej të rinjve. Me moralin e të përgjegjshmit. Por a do ta durojë deri në fund këtë gur Sizifi mbi qafë? A është i përgatitur për ta bërë? E ka kthyer në të përlur tronditja e karriges së pushtetit, apo përlësia si veti njerëzore i ka rezistuar mrekullueshëm magjistricave dhe driadave të të qenit njësh për 6 vjet rresht? Të shohim. Marshi mbrapsht kësaj radhe ishte shumë më i fuqishëm se në nëntor 2013. Nëse në atë kohë gjelliti (në mënyrë krejtësisht të justifikuar) përpara amerikanëve "Po-në" e vet të fillimit, tani u desh të rishohë më shumë se gjysmën e qeverisë. Duke guxuar të sjellë njëherë të panjollë që sigurisht do të bëjnë mirë, në krahësim me krijesa partiake të mësuar me deformim informacioni ekonomik. Nuk ka rëndësi që nuk kërkoi dalje përpara studentëve. Falje që për tre vjet e gjysmë (që nga 22 korriku 2015) u shiti të gjithëve si një reformim të hatashëm një ligj të ri për arsimin e lartë që nuk u zbatua si duhet në asnjë pore të neneve të tij. Duke i katandisur studentët, ngelës dhe jo-ngelës në lopë që u molën barbarisht nga abuzuesit (në pjesën më të madhe edhe të paaftë) të sistemit. Dëgjimi me durim i çdo shfryrjeje të studentëve përbënte disi një ndjesë, edhe pse e fshehur, e timonierit karshi tyre. Pse kishte besuar dhe ishte ngrohur me bukurinë e ftohtë të ligjit të përsosur dhe i kishte lënë në cektinë, në mëshirë të fatit. Kurse me ekonominë publike dhe interesat e të gjithë neve për një të ardhme më të mirë, nuk ka protesta. Nuk kemi pasur kurrrë. Edhe pse protesta studentore, për fat të mirë, po kthehet tek ne në institucion. Ende nuk kemi dalë ndonjëherë në rrugë (hiq sindikatat një herë në dhjetë/vjet



për interesat tona ekonomike. Prandaj dhe kush na ka udhëhequr në këto 28 vjet ka bërë çka dashur me ekonominë e të gjithë shqiptarëve, me ekonominë publike! Pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë, përjashtoj denoncimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Timonieri, edhe pa protesta, po luan sërish me marshin mbrapsht. Do Zoti dëgjon njeriun e ndershëm dhe njohës të mirë të tenderëve publikë që javët e fundit ka marrë pranë vetes. Nga lëvizjet e para duket se po e dëgjon. Koncesioni-PPP i një aksi rrugor që u nis me projekt 225 milionë euro dhe përfundoi në gati 400 milionë euro(?!). I ktheje mbrap-

sht. Do të rifillojë nga e para. Banorët pranë parkut të Zagories protestuan për provat për shpim nafte dhe me një "nuk bën vaki" në rrjetin shoqëror "Instagram" i tregoi kompanisë ndërkombëtare të mirënjohur për shpim-kërkimin e naftës se nuk ka punë me parqet kombëtare të Shqipërisë, edhe po ta shpjerë atje gjurmimi i naftës dhe se ky shtet ka zot. Kompania u tërhoq në mënyrë më dinjitoze. Këto janë disa shenja të mira për më pak se katër javë punë të qeverisë së ringritur. Po a do të arrijë timonieri ta mbajë marshin mbrapsht edhe për më shumë dhe më mirë me çmenduritë konce-

sionare dhe fiskale të mëparshme, edhe të së kaluarës me të afërt? E freskët fare është e pabëra e uljes gati përgjysmë e takses mbi zengjinët (ulja e tatimit mbi dividendin nga 15 në 8 përqind). Si të thuash, medemek, meqë pasunarët tanë për rrogat që u vinin vetes taksoheshin me 23 përqind dhe janë mëzritur për këtë kontribut ndaj shtetit, ata po i kalojnë paratë që fitojnë tek ndarja e dividendit (fitimit të kompanive aksionere pasi janë hequr shpenzimet, nëse kjo para nuk ri-investohet), ku ish-drejtuesi i ministrisë përbindësh (edhe financa publike, edhe ekonomia, edhe të drejta punësimi) mendoi për ta dhe ua uli detyrimin ndaj shtetit me 47 përqind! Që të pasurohen edhe më shpejt të shkretët! Këtë ulje njeriu i ndershëm dhe i zotë që ka sjellë afër e kundërshtoi publikisht. A do ta kapë timonieri marshin mbrapsht në korrik 2019, kohë kur rishikohet buxheti dhe ndoshta mund të preket edhe paketa fiskale, për ta kthyer tatimin mbi dividendin sërish në 15 përqind? A do të vazhdojë me zmbrapsjtë e menduara mirë që i bëjnë mirë ekonomisë sonë dhe që, sikurse thotë Makilaveli, janë arti i pathyeshmërisë?

Me moralin e të përgjegjshmit. Por a do ta durojë deri në fund këtë gur Sizifi mbi qafë? A është i përgatitur për ta bërë? E ka kthyer në të përlur tronditja e karriges së pushtetit, apo përlësia si veti njerëzore i ka rezistuar mrekullueshëm magjistricave dhe driadave të të qenit njësh për 6 vjet rresht? Të shohim. Marshi mbrapsht kësaj radhe ishte shumë më i fuqishëm se në nëntor 2013.

HOROSKOPI

DASHI

Gjeni diçka që ju pëlqen të bëni dhe bëjeni atë! Edhe nëse nuk do të fitojë asnjë çmim, së paku do të përfundoni ditën tuaj duke e ditur se keni bërë diçka. Të krijosh është një përvojë e fuqishme.

DEMI

Nëse ndjeni se askush nuk është duke ju dëgjuar në atë që keni për të thënë, vazhdoni të përqipni të gjeni mënyrën tuaj për të bërë përshtypje të mjaftueshme. Të qenit unik është çelësi.

BINJAKET

Dikush ose diçka që ju intereson mund të jetë në rrezik tani. Ky nuk është një kërcënim serioz, por gjërat mund të mos ecin, siç keni shpresuar. Përqipni t'i jepni një goditje të fortë pengesave në jetën tuaj.

GAFORJA

Kur ju vjen një shans për t'u larguar nga dramati apo presionet e jetës, atëherë mos e humbisni atë. Durimi juaj po rritet, dhe ju jeni gati të ngadalësoni dhe të shihni gjërat siç duhet.

LUANI

Një zë i jashtëm do të tingëllojë më i ëmbël se kurrë më parë, dëgjoni atë që ka për të thënë dhe provoni disa nga sugjerimet e tij të freskëta. Ju jeni një një udhëkryq interesant ku mund t'i jepni energji të barabartë qëllimeve tuaja dhe qëllimeve të të tjerëve.

VRIGJERESHA

Gjithçka të bëjë gjithnjë me qëndrimin pozitiv dhe optimist. Mos ngurroni të transmetoni mendimet tuaja tek njerëzit që ju rrethojnë dhe të jeni gati për disa diskutime të nehta që do t'ju shoqërojnë me dikë që është po aq i ditur sa ju.

PESHORJA

Një nga marrëdhëniet tuaja që po zhvillohet dita ditës kërkon shumë energji nga ju kohët e fundit. Përqipni të vendosni disa kufij dhe do të shikoni rezultate shumë të efikase.

AKREPI

Dita do të jetë e mbushur me opione, dhe detyra juaj do të jetë të mbani sa më shumë prej tyre që të jetë e mundur. Ju mund të përfitonë nga një pikë kthese e madhe në dashuri.

SHIGJETARI

Nuk ka asnjë dyshim se do të keni të gjithë energjinë që ju nevojitet për të bërë gjëra të suksesshme sot, prandaj mos u shqetësoni. Kjo është një kohë kur duhet të dëgjosh veten si fizikisht ashtu edhe emocionalisht.

BRICJAPI

Mos harroni se komunikimi është një rrugë me dy opsione dhe është e pamundur që dy të dëgjoni gjatë kohës që flisni. Zgjidhni sot për të folur më pak dhe për të dëgjuar më shumë.


UJORI

Uluni dhe qetësohuni ndërsa njerëzit e tjerë bëjnë të gjitha punët. Nuk ka asgjë të keqe në këtë aspekt, sepse edhe ju keni bërë pjesën tuaj. Një investim duhet të mbani pak më shumë nën vëzhgim.

PESHQIT

Tani është koha për të nisur një aventura të re në dashuri. Mos ngurroni të shprehni ndjenjat, sepse nuk do të përballeni me kokëfortësi. Në punë do t'ju duhet të merrni disa vendime të rëndësishme.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Eshhtë babëzia. 8. Burton regjisor. 11. Skllavja e Abrahamit. 12. Një dite në mbledhje. 14. Tyson i boksit. 15. Rrethojnë ringun. 17. Beson pa kufij. 19. Zola që shkroi Nana. 20. Eshhtë ankimum. 23. Pak elementare. 24. Janë me para në bankë. 26. Matet pa kufij. 27. Janë ngrehina për reparte fabrikash. 28. Një zog i verdhë. 29. Inicialet e Moravia-s. 31. Qytet gjerman. 34. Një zonjë që ha gurë. 35. Pak analogji. 36. I ka plasur të paturpit. 37. Janë legjendat.

- 38. Nuk ka akoma një bebe. 39. Fillojnë mirë. 40. Janë brinjë në skuadër. 42. Shkruhet i shtati. 44. Nget edhe ajo e mirë 47. Mbahet në gisht. 48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

- 1. Kanë shpate të tilla. 2. Janë edhe ato polare. 3. Janë mizorët. 4. Janë malë në Rusi të tilla 5. Eshhtë nusja me vello. 6. Një rreth pa ekstreme. 7. Mbyllin kuvendin. 8. Në kryt të titujve 9. Diku në qendër. 10. Markë cigaresh. 13. Janë rrefimet e të pandehurit. 14. Janë penjtë për gjergjer. 16. Mbarojnë fare. 18. Janë stitët e... provimeëve. 20. Mund të jenë fotografikë të tillë. 21. Vitet pa kufij. 22. Një fjalë për tutje. 24. Brown i Kodi i Da Vinci-t. 25. Eshhtë e akuzuara... injorante 26. Baldwin aktor 27. Një pjesë e kandidatëve. 38. Krenar pa çift. 30. Grazia Cucinotta. 32. Paul këngëtar. 33. Janë pëshjtellat. 35. Inicialet e Moravia-s. 37. Pak makinacione. 38. Samuel bomber kamerunas. 40. Markë makinë koreane. 41. Ente Kombëtare Durrës. 42. Fillojnë kurat. 43. Inicialet e Zemeckis regjisor. 45. Ekstreme në liitar. 46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Satelit i Uranit. 6. Eshhtë edhe ai i Pallës. 11. Tiran pa kufij 12. Në krye të armatës. 13. Një Ibrahim violinist. 14. Qendër ditore. 15. Mund të jenë fotografikë. 17. Inicialet e Einstein. 18. Një mbishkrim në kryq. 20. Janë si vite. 21. Thurman aktore. 22. Të parat në irritim. 23. I preu Seneka. 25. Fillojnë iustrimet 26. Isaac Asimov. 27. Një Vladimir kompozitor. 28. Janë në modë. 30. Janë zyrat... qeveritare 32. Me të nxjerrin trarë. 35. Një shklop, thupër.

VERTIKAL


- 37. Eshhtë Shqipëria e madhe. 39. U thyen në Salamina. 40. Një raport shumë i ngushtë. 41. Nota e diapzonit. 42. Fund heroi. 43. Një top në rrjetë. 45. Gjysma alarmi. 46. Herët pa zë. 47. Sampras i tenisit. 48. Me to bëjnë triko. 49. Një guajitje fluturimthi në tenis. 50. Janë kokrrat e listit.

VERTIKAL


- 1. I famshëm ai i Sizifit. 2. Mund të jetë e hollë dhe therëse. 3. Fillojnë rastësisht. 4. Një pjesë e napolitanëve. 5. Janë situatat e rreziqshme para portave. 6. Mund të jenë kundërajrore. 7. Lindin në kokë. 8. Gjysmë shtegu. 9. Hidhen të parat. 13. Një fjalë për tutje. 15. Fundi i një samurai. 16. Mbyllen me epilog. 17. Bel i maupassant. 19. Inicialet e Redford. 23. I manifeston nxënësi i papërgatitur. 24. Në hyrje të tokës. 26. Pak impresioniste. 27. Janë metrat në sipërfaqe 29. Hapet një për ajër. 30. Gjysmë krenar. 31. Një hidrokarbur. 33. Vrau Hektorin. 34. Një film i rixhiruar. 36. Kupat pa kufij. 38. Inicialet e Nolte aktor. 41. Ullimann aktore. 43. Një britaninë moderne 44. Hotel pa kufij. 46. Ekstreme në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

Sudoku grid with numbers: Row 1: [] [2] [7] [] [] [] [] [] [6] []; Row 2: [1] [3] [] [] [] [] [] [] []; Row 3: [] [] [] [4] [] [5] [1] [] []; Row 4: [9] [] [] [] [8] [] [] [] []; Row 5: [] [] [6] [3] [] [1] [5] [] []; Row 6: [] [] [] [] [9] [] [] [8] []; Row 7: [] [] [] [1] [8] [] [2] [] []; Row 8: [] [] [] [] [] [] [] [2] [9] []; Row 9: [5] [] [] [] [] [] [7] [3] [] []

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Solved 9x9 Sudoku grid with numbers from 1 to 9 in each row and column.

Argëtim filozofik

-Mos i beso asgjëje , s'ka rëndësi ku e ke dëgjuar ose kush e ka thënë , edhe sikur ta kem thënë unë , vetëm nëse është e pranueshme dhe e kuptueshme për arsyen tënde .

-Kush nuk ka plagë në dorë mundet të prekë helmim me atë dorë : helmim nuk penetron aty ku nuk ka plagë ; dhe nuk është mëkat (vepra) për ata që nuk e ka mëkat .

-Eshhtë më e rëndësishme të parandalosh që një kafshë të vuajë , sesa të rrish ulur e të meditosh për të kjojtat e Universit duke u lutur në shoqërinë e pritërinjve .

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

Cryptogram puzzle with a grid of letters and numbers. The grid contains the text: KULTMA PLAB, OREKASTILER, RULAKTORIALE, B KLEOPATRA, IEKITRETES, LAMETERMAT, TERMATARICE, OTOSCIRMA, BREDDHIAIRK, ILEINEPHIL, ANALITIKEAMI, SEETESKICATO

PËRÇJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

Answers to crossword puzzles: M A R K U T E R E R I T I M I, A G A R R E N D M I K E, L I R R E T E S O R, E M I L I E A P E L I M I, E L E D E P O Z I T A R, A T E K A P A N O N E T, L E K A N A R I N E A M, E S S E N D A M E A N A, C I P A M I T E E M E R, M I K A T E L E I T, K O R R I K U K O L I A, U N A Z A R E N D O R E, M I R A N D A B I S H T I, I R A A R M A D H I D, I O A P A R A T E T A E, I N R I M O T E T U N A, I R D A M A R E T I L, I A K O T A N I O D, M K A B I N E T E R A R, P U R T E K E E T N I K E, P E R S L E T N I M A, I O I G O L M I A, I H R T P E T E R I N, V O L E E L E N D E E

FJALËKRYQI (1) FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Mos i besoni shkrimeve të vjetra , mos besoni asgjë vetëm se populli juaj i beson , ose sepse ju kanë detyruar t'i besoni që nga fëmijëria . Ndjaj çdo gjëje veproni me arsye ; pasi ta keni analizuar , nëse mendoni se është mirë për të gjithë , atëherë
- besojni , jetojeni , dhe ndihmoni fqinjnin tuaj ta përfjetojë edhe ai vetë .
- Njeriu duhet të shpëtojë veten me përpjekjet e veta , asnjë nuk mund të bëjë për të , atë që ai duhet të bëjë për vete .

